

Raport mbi të drejtat e njeriut 2007

KOSOVË

Kosova ka rreth 2.2 milionë banorë dhe administrohet nga Misioni i administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë (UNMIK), në përputhje me Rezolutën 1244 të vitit 1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (KSKB). UNMIK-un e kryeson një përfaqësues special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së në Kosovë (PSSP). UNMIK-u nxori rregullore që u qaseshin përgjegjësi civile dhe ligjore të subjekteve qeveritare dhe të individëve privatë, dhe ratifikoi ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Korniza Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë, e shpallur nga UNMIK-u, i definon institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ). Zgjedhjet shumëpartiake në nëntor për Kuvend të Kosovës në përgjithësi pasqyruan vullnetin e votuesve. Gjatë këtij viti, negociatat që synonin zgjidhjen e statusit të Kosovës u mbajtën nën mbikëqyrjen e OKB-së. Asnjë vendim për statusin e Kosovës nuk u arrit deri në fund të vitit. Autoritetet civile ndërkombëtare të UNMIK-ut dhe forca paqeruajtëse për Kosovën (KFOR), e autorizuar nga OKB-ja, dhe e udhëhequr nga NATO-ja, në përgjithësi mbajtën kontroll efikas ndaj forcave të sigurimit.

UNMIK-u dhe IPVQ-ja në përgjithësi i respektuan të drejtat e njeriut; megjithatë, pati probleme në disa zona, posaçërisht lidhur me popullatat pakicë. Më seriozet nga këto ishin rastet e vrasjeve me motive politike dhe etnike; lëndimet nga mjetet e pashpërthyer ose minat tokësore; paraburgimi i gjatë dhe mungesa e procesit të drejtë gjyqësor; korrupsioni dhe ndërhyrja e qeverisë në gjyqësi; antipatia shoqërore ndaj serbëve dhe kishës ortodokse serbe; mungesa e përparimit në kthimin e personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre; korrupsioni brenda IPVQ-së; dhuna dhe diskriminimi ndaj femrave; trafikimi i personave, posaçërisht i vajzave dhe i grave për shfrytëzim seksual; dhuna shoqërore, abuzimi dhe diskriminimi i bashkësive pakicë; diskriminimi shoqëror i personave me aftësi të kufizuara; abuzimi dhe diskriminimi i homoseksualëve; dhe puna e fëmijës në sektorin joformal.

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Seksioni 1 Respektimi i integritetit të personit, përfshirë këtu lirinë nga

a. Privimi arbitrar ose i paligjshëm i jetës

Qeveria apo agjentët e saj nuk kryen asnjë vrasje me motive politike; megjithatë, forcat e UNMIK-ut vranë dy persona gjatë demonstratave.

Gjatë demonstratave të 10 shkurtit të Lëvizjes Vetëvendosja, të cilat u bënë të dhunshme, forcat e sigurimit të UNMIK-ut vranë dy civilë me plumba gome dhe plagosën rënd dy të tjerë. Pas këtij incidenti, komisar i policisë së UNMIK-ut, Stephen Curtis, dhe ministri i Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepi, dhanë dorëheqje nga postet e tyre. Në korrik, pas një hetimi paraprak, Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi, konkludoi se humbja e jetës ishte e pajustificueshme dhe faktet ofruan dyshim të arsyeshëm të veprave penale ndër personelin e sigurimit që kishte shtënë plumba gome. Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi gjithashtu konkludoi se nuk kishte prova të mjaftueshme për të ngritur akuzë ndaj ndonjë polici në veçanti. Hetimi, i cili vazhdoi deri në fund të vitit, zbuloi se forcat e sigurisë kishin përdorur plumba të gomës me afat të skaduar. Si rrjedhojë, UNMIK-u ndaloi përdorimin e plumbave të gomës nga forcat e veta të sigurisë. Albin Kurti, udhëheqësi i të ashtuquajturës “Lëvizja Vetëvendosje”, u akuzua për pjesëmarrje dhe organizim të masës që kreu vepër penale, për pjesëmarrje dhe udhëheqje të grupit që pengoi zyrtarët në kryerjen e detyrave të tyre, dhe për thirrje për rezistencë. Gjykimi i tij vazhdoi deri në fund të vitit. Disa organizata ndërkombëtare për të drejta të njeriut shprehën shqetësim për paraburgimin e gjatë të Kurtit dhe sjelljen e UNMIK-ut gjatë gjykimit.

Nuk pati zhvillime në rastin e dhjetorit 2006 të Hetem Sadri Rexhajt, që u vra në stacionin policor në Pejë.

Ndryshe nga viti 2006, nuk pati raportime për vdekje nga minat tokësore apo mjetet e pashpërthyer nga konflikti i vitit 1998-1999.

Nuk pati zhvillime në hetimin e këtyre vrasjeve që mund të kenë qenë me motive politike: vrasja në maj 2006 e Mark Oroshit, për të cilin dyshohej se e kishte vranë Shaban Manajn, avokat dhe aktivist politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Istog, më 2001, apo vrasja në qershor 2006 e serbit të Kosovës Dragan Popoviq, që u qëllua dhe u vra në shtëpinë e tij në komunën e Klinës etnikisht të përzier.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati vrasje të policëve me motive politike. Megjithatë, dy policë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) u vranë gjatë këtij viti. Më 3 janar, polici Avni Kosumi u qëllua dhe u vra afër fshatit Babimoc gjersa ishte duke vozitur në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë. Ai ishte me dy policë të tjerë të SHPK-së që nuk ishin në detyrë. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Më 30 gusht, polici i SHPK-së Triumf Riza u qëllua në një parking në Prishtinë gjersa ishte jashtë detyrës dhe vdiq pas pak kohësh në spital. Më 1 shtator, Arben Berisha pranoi se e kishte kryer vrasjen dhe iu dorëzua policisë. Krimineli i njohur vendës, Enver Sekiraqa, u akuzua publikisht për përfshirje në këtë vrasje; në fund të vitit, SHPK-ja ishte duke i hetuar lidhjet e tij të supozuara me këtë krim.

Më 2006, gjykimi i Shkumbin Mehmetit, Florim Ejupit, Nazim Kadriut, Arben Ahmetit dhe Arsim Rashitit për vrasje filloi para gjykatësve ndërkombëtarë. Këta të dyshuar u akuzuan më 2005 për vrasjen e një polici të SHPK-së dhe të një polici të UNMIK-ut në pritë në rrugën për në Podujevë pas trazirave të marsit 2004. Më 9 nëntor, Gjykata e Qarkut në Prishtinë dënoi Mehmetin për vrasje të rënduar, tentim vrasje dhe tri akuza për posedim të paautorizuar të armëve, ndërsa e liroi nga akuzat e tjera të aktakuzës. Shkumbin Mehmeti u dënua me 30 vjet burg. Florim Ejupi, Nazim Kadriu, Arben Ahmeti dhe Arsim Rashiti u liruan nga të gjitha akuzat. Një aktgjykim i veçantë ishte lëshuar për vazhdimin e paraburgimit të Mehmetit derisa vendimi të mos merrte formën e prerë.

Florim Ejupi ishte paditur edhe më parë nën akuzat se ai dhe bashkëpunëtorët e tij kishin planifikuar dhe kryer sulmin me bombë më 2001 ndaj një autobusi në Merdarë, afër Podujevës, me ç'rast 11 serbë të Kosovës u vranë dhe 40 u plagosën. Më 9 gusht, prokurori ndërkombëtar ndryshoi aktakuzën duke tërhequr akuzat për terrorizëm kundër të gjithë të pandehurve, si dhe duke hedhur poshtë akuzat ndaj pesë të pandehurve. Më 30 nëntor, duke vepruar sipas kërkesës së paraqitur nga prokurori publik ndërkombëtar, gjykata ua vazhdoi paraburgimin të pandehurve edhe për dy muaj. Gjykimi vazhdoi deri në fund të vitit.

Më 19 shtator, gjykata rajonale e Pejës e dënoi Bedri Krasniqin me 27 vjet burg për vrasjen më 2003 të policëve të SHPK-së Sebahate Tolaj dhe Isuf Haklaj.

Nuk pati zhvillime në disa raste të supozuara të krimeve të luftës nga vitet e kaluara. Më 17 janar, Gjykata e Qarkut në Prizren mbylli hetimet për dy ish-policë serbë të Kosovës, Goran Janjusheviq dhe Sllavisha Millkoviq, për krime lufte të kryera kundër popullatës civile në rajonin e Prizrenit gjatë konfliktit të vitit 1999. As Janjusheviq as Millkoviq nuk ishin arrestuar.

Më 8 shkurt, prokurorët ngritën padi kundër Idriz Gashit, i cili u soll nga Suedia në Kosovë për t'u ballafaquar me akuzat për krime lufte të kryera më 1998 në rajonin e Pejës. Në qershor, Gashi u dënua për vrasjen e Sanije Balajt, shqiptare e Kosovës, më 1998, pasi ajo ishte ndalur në një postbllok të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në fshatin Baran. Ai u dënua me 15 vjet burg.

Nuk pati zhvillime në rastin e eprorëve shqiptarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhavit Elshani, Isuf Gashi, dhe Islam Gashi), të arrestuar për përfshirje të supozuar në krime lufte të kryera kundër civilëve shqiptarë në kampin e ndalimit në Drenoc, Prizren, më 1998. Selim Krasniqi u arrestua më 24 nëntor dhe gjendej në paraburgim në pritje të gjykimit në fund të vitit. Më 19 prill, policia e UNMIK-ut arrestoi Osman Zyberajn, i cili akuzohej për vrasjen e Hasan Rustemit më 2005 dhe tentim vrasjen e Nezir Rustemit, që të dytë dëshmitarë të gjykimit që ishte duke vazhduar asokohe kundër Krasniqit. Më 17 korrik, një prokuror ndërkombëtar ngriti padi kundër Zyberit dhe një të dyshuari tjetër, Shyqeri Shala.

Më 22 gusht, Gjykata Supreme e liroi Sali Veselin nga akuza për vrasjen e një ish-udhëheqësi të UÇK-së nga Prizreni dhe urdhëroi lirimin e tij të menjëhershëm. Ky vendim i gjykatësve ndërkombëtarë e përmbyti vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit për dënimin e Veselit.

Nuk pati zhvillime në hetimet e vrasjes së policit të UNMIK-ut Omar Ali, më 2005, i cili vdiq pas shpërthimit të një bombe nën veturën e tij zyrtare.

Nuk pati zhvillime në vrasjen me sa duket me motive politike më 2005 të turkut etnik e anëtar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës, Ibish Cakalli. Hetimet vazhduan deri në fund të vitit.

Nuk pati zhvillime në këto vrasje me sa duket me motive politike të shqiptarëve të Kosovës më 2005: vrasja e Sadik Musajt, dëshmitar në gjykimin e "Grupit të Dukagjinit"; vrasja e Muhamet Sallajt, ish-pjesëtar i UÇK-së; vrasja nga një veturë në lëvizje e gazetarit të së përditshmes *Bota Sot*, Bardhyl Ajeti; vrasja nga një veturë në lëvizje e Muhamet Xhemajlit, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, një grup i armatosur i shqiptarëve të Kosovës më parë aktiv në Luginën e Preshevës, Serbi; dhe eksplodimi i veturës së pjesëtarit të TMK-së e ish-pjesëtar i UÇK-së, Naser Ramaj, dhe vëllait të tij Jetonit.

Nuk pati zhvillime në rastin e Faton Hajrizit, i arrestuar më 2006 për vrasjen e supozuar të një ushtari të KFOR-it rus në Klinë më 2002. Më 18 gusht, ai iku nga burgu i Dubravës; policia e arrestoi atë në një kafene në Prishtinë më 5 tetor.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje me motive politike; megjithatë, mijëra persona ende ishin të zhdukur që nga konflikti i vitit 1998-99, kufomat e të cilëve nuk ishin identifikuar apo nuk dihej për fatin e tyre.

Sipas Komitetit ndërkombëtar të kryqit të kuq (ICRC), në fund të qershorit, 2,047 persona gjendeshin në listën e personave që ende mungonin që nga konflikti, prej të cilëve 70 për qind ishin shqiptarë të Kosovës dhe 30 për qind serbë të Kosovës dhe pakica të tjera.

Gjatë këtij viti, Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) vazhdoi identifikimin e trupave të pajetë të personave të zhdukur në Kosovë. Që nga viti 2002, zyra kreu 571 operacione dhe zhvarrosje në terren, 66 e të cilave ndodhën gjatë këtij viti. Trupat e pajetë të mbi 3,800 personave të zhdukur ishin zbuluar dhe ZPZHML u përqendrua në përcaktimin e identitetit të 1,500 trupave të pajetë të zbuluara në Kosovë që nga viti 1999, krahas identitetit të përafërsisht 900 trupave të pajetë të pranuar nga Serbia që nga viti 2002.

Nga fundi i këtij viti, 455 trupa të pidentifikuar ishin nën kujdesin e ZPZHML-së (397 trupa ishin zhvarrosur në Kosovë dhe 58 ishin transferuar nga Serbia). Ndërmjet janarit dhe gushtit, ZPZHML pranoi 180 raporte pozitive të ADN-së, që përfaqësonin 77 individë të identifikueshëm. Gjatë këtij viti, ZPZHML dhe Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur punuan në identifikimin e 61 rasteve të personave të zhdukur për të cilët nuk kishte dhurues të mjaftueshëm të gjakut për të siguruar informata për krahasim. Të dhënat nga ADN-ja dhe metodat tradicionale u kombinuan për ta konfirmuar identifikimin e trupave të pajetë. Nëntë grupe të trupave të pajetë u kthyen gjatë këtij viti; procesi i identifikimit të trupave të tjerë vazhdoi.

Gjatë këtij viti, ZPZHML gjithashtu vazhdoi me zhvarrosje; zbuloi dhe bëri autopsinë në 73 trupa të pajetë nga 66 vende. Zhvarrosjet ishin në vazhdim e sipër në fund të vitit.

Në qershor 2006, qeveria serbe transferoi grupin e fundit të kufomave të identifikuara të shqiptarëve të Kosovës nga konflikti i vitit 1998-99 të gjetura në varrezat masive në Serbi. Këto kufoma iu kthyen familjeve për varrim. Familjet e personave të zhdukur vazhduan të kërkonin nga qeveria serbe që t'u ofronte qasje në dokumentet që do të mund të tregonin për lokacionet e varrezave të tjera masive apo të vendeve ku trupat mund të kenë qenë djegur.

Zyrtarë nga Kosova dhe Serbia u takuan katër herë gjatë këtij viti në kuadër të grupit punues për persona të zhdukur, të kryesuar nga ICRC-ja dhe nën patronazhin e PSSP-së. Edhe pse një nëngrup punues për çështje të mjekësisë ligjore u takua dy herë në gjysmën e parë të këtij viti dhe palët mbajtën disa telekonferenca në çështje të mjekësisë ligjore, qindra trupa të pajetë mbetën të pidentifikuar në morgun e Prishtinës.

Sipas ICRC-së, në periudhën ndërmjet janarit dhe gushtit, 155 trupa të pajetë ishin identifikuar dhe u ishin dorëzuar familjeve. 41 ishin transferuar nga Serbia në Kosovë (përmes ICRC-së); 16 ishin transferuar nga Kosova në Serbi (ishin zhvarrosur në Kosovë dhe u ishin dorëzuar familjeve në Serbi), dhe 98 ishin transferuar brenda Kosovës (ishin zhvarrosur në Kosovë dhe u ishin dorëzuar familjeve në Kosovë).

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Korniza Kushtetuese dhe kodi i procedurës penale ndalojnë praktika të tilla; megjithatë, pati raportime që IPVQ-ja ishte e përfshirë në praktika të tilla. Nuk pati raportime që UNMIK-u, i cili ka autoritet sovran, apo KFOR-i, i cili ka autoritet të kufizuar për arrestim dhe ndalim, ishin të përfshirë në praktika të tilla.

Sipas raporteve të mediave, SHPK përdori forcën për t'i shpërndarë demonstratat e dhunshme dhe rrahu demonstruesit gjatë arrestimeve në demonstratat e 10 shkurtit. Institucioni i ombudspersonit filloi një hetim për protestat e 10 shkurtit dhe u dërgoi letra PSSP-së dhe kryeministrit, përmes të cilave kërkonte që ata ta përdornin autoritetin e tyre për të siguruar hetime të pavarura për sjelljen e policëve gjatë kësaj proteste.

Njësia e SHPK-së për standarde profesionale inicioi tri hetime, një prej tyre u hodh poshtë si i pabazuar. Dy hetimet e tjera rezultuan në masa disiplinore kundër policëve të përfshirë. Ata u suspenduan nga 10 ditë pa pagesë, iu nënshtuan trajnimit të detyrueshëm, dhe masat ndëshkimore u regjistruan në dosjet e tyre personale.

Kushtet e burgjeve dhe të qendrave të ndalimit

Burgjet dhe qendrat e ndalimit në përgjithësi i plotësonin standardet ndërkombëtare; megjithatë, pati pohime për abuzim dhe keqtrajtim të të burgosurve gjatë këtij viti.

Më 18 gusht, shtatë persona të burgosur për terrorizëm, vrasje, tentim vrasje dhe vjedhje ikën nga burgu i Dubravës. Një i burgosur gjoja shtiu dy herë brenda në burg, dhe persona të panjohur shtinë me armë automatike në muret e jashtme të objektit për t'i mbuluar të burgosurit gjatë ikjes. Granata të mortajës së dorës u gjetën më vonë jashtë mureve të burgut. Divizioni i drejtorisë penale i Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi mori përsipër kontrollin e burgut për një ditë. Pesë nëpunës të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) u arrestuan. Drejtori burgut të Dubravës, Sokol Zogaj, dha dorëheqje më 27 gusht. Policia arrestoi një të arratisur në një kafene në Prishtinë më 5 tetor dhe një tjetër jashtë Prishtinës pak më vonë. Një i arratisur u vra në një përleshje të armatosur afër Tetovës, Maqedoni, më 1 nëntor, dhe dy të tjerë vdiqën në një përleshje të armatosur në të njëjtin rajon më 7 nëntor. Dy të arratisur mbetën në liri në fund të vitit.

UNMIK-u raportoi se procedurat disiplinore ishin ngritur kundër pjesëtarëve të SHKK-së që kishte 1,650 pjesëtarë, gjatë këtij viti. Sjelljet që rezultonin në masa disiplinore përfshinin shkelje administrative, si vonesën e shpeshtë dhe mashtrimin.

Burgu i Dubravës kishte 1,161 të burgosur më 1 korrik, kurse kapaciteti i tij ishte për 1,100 veta. Burgu i Dubravës dhe pesë qendra të ndalimit punuan gjatë këtij viti, dhe ndërtimi i një burgu të ri vazhdoi në Lipjan për ta lehtësuar mbingarkesën.

Gjatë këtij viti, policët korrektues të policisë së UNMIK-ut vazhduan bartjen e përgjegjësive për administrimin e burgjeve të Kosovës tek SHKK-ja, nën autoritetin e IPVQ-së. SHKK-ja udhëhoqi punët ditore në burgun e Dubravës, me përjashtim të sektorit 32 për të burgosur të rrezikut të lartë, që mbeti nën mbikëqyrje ndërkombëtare. UNMIK-u mbajti autoritetin për ta marrë kontrollin e plotë ndaj sistemit të burgjeve gjatë emergjencave.

UNMIK-u i lejoi ICRC-së vizita dhe ombudspersonit monitorim të burgjeve dhe qendrave të ndalimit të Kosovës. Në shkurt, Ministria e Drejtësisë i lejoi Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), një OJQ vendëse, qasje të plotë në të gjitha burgjet, qendrat e ndalimit dhe qendrat korrektuese. KMDLNJ ishte ankuar më parë se i ishte mohuar qasja në disa raste. Në mars, përfaqësuesit e Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) vizituan burgjet dhe qendrat e tjera të ndalimit. Delegacionit iu ofrua qasje e plotë edhe në qendrën e ndalimit në një bazë të NATO-s/KFOR-it. Gjatë këtij viti, ICRC-ja vizitoi disa burgje të Kosovës, por nuk lëshoi konkluzione publike mbi vizitat e veta.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Korniza Kushtetuese dhe kodi i procedurës penale ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar, dhe UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi i respektuan këto ndalesa në praktikë.

Roli i policisë dhe i aparatit të sigurimit

Forcat vendëse të sigurisë përfshinin TMK-në, organizatë civile për reagime emergjente, dhe SHPK-në, forcë vendëse policore që funksionon nën autoritetin e PSSP-së dhe nën mbikëqyrjen e policisë së UNMIK-ut. Ministria e Punëve të Brendshme u themelua në bazë të një rregulloreje të UNMIK-ut, të dhjetorit 2005, e cila, sipas Kornizës Kushtetuese, është përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Ministri i parë i Punëve të Brendshme u emërua më 2006, dhe SHPK-ja u bë agjenci ekzekutive nën këtë Ministri. UNMIK-u mban autoritetin ekzekutiv mbi policinë, por vazhdoi kalimin e kompetencave dhe të funksioneve policore tek SHPK-ja.

Një komisar ndërkombëtar i policisë i drejtonte policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në. Një zëvendëskomisar kosovar dhe katër ndihmëskomisarë kosovarë i raportonin komisarit ndërkombëtar të policisë. Anëtarët e pakicave etnike përbënin përafërsisht 16 për qind të 7,200 policëve të SHPK-së në fund të vitit; 10 për qind e policëve të SHPK-së ishin serbë të Kosovës. 13.5 për qind e policëve të SHPK-së ishin femra.

Autoriteti ekzekutiv mbi SHPK-në është kompetencë e rezervuar e PSSP-së. Operacionet ditore të policisë i janë kaluar SHPK-së në të gjitha rajonet, përveç Mitrovicës. Në ato rajone, SHPK-ja është përgjegjëse për të gjitha shërbimet policore dhe aktivitetet ditore. Njësitë e specializuara për krime lufte dhe krime me motive etnike ende ishin të plotësuara me policë ndërkombëtarë të OKB-së dhe kryesisht vepronin pavarësisht nga SHPK-ja për shkak të ndjeshmërisë së atyre funksioneve. Njësitë për zbulim penal dhe krim të organizuar vepronin bashkërisht. Policia dhe gjyqësia ndërkombëtare kanë diskrecion të gjerë për të intervenuar në ndonjë çështje të veçantë penale. Si çështje praktike, shumica e detyrave dhe përgjegjësi policore ishin në duar të SHPK-së.

Korrupsioni dhe ndikimi i qeverisë mbetën problem ndër forcat e sigurimit.

Më 2006, Ministria e IPVQ-së për Punë të Brendshme dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë themeluan Inspektoratin e Policisë së Kosovës, organ i dizajnuar për ta mbështetur efikasitetin e policisë, për ta mbajtur policinë përgjegjëse për veprimet e veta, dhe për ta hetuar dhe dënuar sjelljen e keqe. Inspektorët kryen 14 auditime dhe inspektime gjatë këtij viti, përfshirë këtu një që ka të bëjë me protestat e 10 shkurtit të Vetëvendosjes.

Një Zyrë e UNMIK-ut për mbikëqyrje hetonte korrupsionin brenda UNMIK-ut dhe sistemit të judikaturës penale. Sistemi gjyqësor në përgjithësi i mbante forcat e sigurimit në të njëjtin nivel të përgjegjësisë siç e mbante popullatën e përgjithshme.

Gjatë këtij viti, njësia e SHPK-së për standarde profesionale, e udhëhequr nga policia e UNMIK-ut, hapi 460 raste ku përfshiheshin 678 nëpunës të SHPK-së; pjesa më e madhe e tyre kishte të bënte me mungesa të pajustificueshme nga puna, keqpërdorim të pushimit mjekësor, përdorim të forcës, fjetje gjatë orarit të punës dhe shkelje të etikës. Në fund të vitit, 376 prej këtyre rasteve u përfunduan, 2,994 u konsideruan të bazuara dhe 68 u konsideruan të pabazuara. Nëntë u mbyllën pa masa hetuese për shkak të dorëheqjes së nëpunësve të akuzuar. Masat ndëshkimore silleshin prej pushimit nga puna deri në suspendim të përkohshëm apo trajnim të obligueshëm. 185 raste ishin në hetim e sipër që nga shtatori; në rastet që kishin të bënin me shkeljen e kodit penal, shumë nëpunës u suspenduan përkohësisht dhe pritnin vendimin e gjykatës.

Në prill, një bastisje e udhëhequr nga SHPK-ja në komunën e Shtërpçës me shumicë serbe, e kryer vetëm nga policët shqiptarë, rezultoi në lëndimin e disa serbëve të dyshuar të Kosovës dhe në pohime të besueshme për përdorim të tepërt të forcës dhe sjellje të pavend. Si rrjedhojë, SHPK-ja filloi një hetim të brendshëm për ta përcaktuar sjelljen e keqe të policisë dhe filloi hartimin e procedurave standarde të punës për operacione policore në zona të serbëve dhe të pakicave të tjera. Hetimi dhe themelimi i këtyre procedurave ishin në vazhdim e sipër në fund të vitit.

Arrestimi dhe ndalimi

Policia në përgjithësi arrestimet i bënte haptas duke përdorur urdhër arrestin e lëshuar nga gjykatësi apo prokurori; megjithatë, në disa raste, personat arrestoheshin në fshehtësi nga policët e maskuar apo sekretë. Sipas ligjit, arrestimet duhet të bazohen në urdhrat e prokurorit, dhe të arrestuarit duhet të sillen para gjykatësit brenda 72 orëve. Shumica e arrestimeve të këtij viti u bënë nga SHPK-ja, jo nga UNMIK-u. SHPK-ja nuk e abuzoi rregullin 72-orësh dhe në përgjithësi i akuzonte të arrestuarit brenda gjashtë orëve apo i lironte. Të arrestuarit kanë të drejtë të informohen, në gjuhën që e

kuptojnë, për shkakun e arrestimit të tyre; të heshtin dhe të mos u përgjigjen pyetjeve, përveç për identitetin e tyre; për ndihmë falas të përkthyesit; për avokat mbrojtës dhe për sigurim të avokatit mbrojtës, nëse nuk mund të paguajnë për ndihmë ligjore; për trajtim mjekësor, përfshirë këtu trajtimin psikiatrik; dhe për ta informuar ndonjë anëtar të familjes. Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja në përgjithësi i respektonin këto të drejta në praktikë. Ligji lejon dorëzaninë, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit, arrestin shtëpiak, dhe masa të tjera si alternativë ndaj paraburgimit, por këto masa u zbatuan vetëm në disa raste.

Nën rrethana të jashtëzakonshme, KFOR-i mund t'i arrestojë dhe ndalojë individët pa urdhër arrest. Komandanti i KFOR-it mund ta vazhdojë ndalimin e individëve, në kohëzgjatje prej 30 ditësh, pa i akuzuar për krime para gjykatës, nëse gjykata nuk ka urdhëruar lirimin e tyre. Nuk pati raportime që KFOR-i kishte arrestuar persona pa urdhër arrest gjatë këtij viti.

Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja mund t'i mbajnë individët deri në 72 orë pa urdhër të gjykatës. Gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim 30 ditë nga dita e arrestimit, por kjo mund të vazhdohet nga gjykatat deri në gjithsej 18 muaj. Ligji lejon arrestin shtëpiak, apelin për paraburgim, dhe përdorimin e gjerë të dorëzansisë si alternativa ndaj paraburgimit.

Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem; ndonëse u raportua për disa përmirësime gjatë këtij viti. Ligji parashikon që gjykatësi mund ta imponojë këtë masë të jashtëzakonshme vetëm kur masat e rëndomta, si arresti shtëpiak, nuk mjaftojnë për ta siguruar praninë e të pandehurit gjatë procedurës penale dhe për të mundësuar administrim të duhur të procedurës penale. Në praktikë, gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin, pa treguar justifikim të mbështetur në prova.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Korniza Kushtetuese parashikon gjyqësi të pavarur; megjithatë, gjyqësia vendëse nganjëherë i nënshtrohej anësisë dhe ndikimit të jashtëm dhe nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Pati raportime të besueshme për korrupsion brenda gjyqësisë vendëse, dhe sistemi i gjykatave ishte joefikas.

Autoritetin ligjor e mban UNMIK-u, sipas Rezolutës 1244 të KSKB-së. Autoritetet e UNMIK-ut për Polici dhe Drejtësi mbanin përgjegjësinë ekzekutive për sistemin gjyqësor, por punonin me gjykatësit dhe prokurorët vendës; UNMIK-u vazhdoi t'ua kalonte disa kompetenca të rezervuara Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që u themelua më 2005. Qeveria e Serbisë vazhdoi ta drejtonte një sistem paralel të palejuar të gjyqësisë në enklavat serbe në Kosovë dhe në komunat me shumicë serbe.

Sistemi i gjykatave përfshin një Gjykatë Supreme, 5 gjykata të qarkut, përfshirë këtu një gjykatë ekonomike, 25 gjykata komunale, 25 gjykata për kundërvajtje, dhe një gjykatë të apelit për kundërvajtje. Që nga tetori, 174 gjykatës ndërkombëtarë dhe 13 prokurorë ndërkombëtarë ishin të emëruar nga UNMIK-u. Në janar, UNMIK-u dhe Ministria e Drejtësisë themeluan Zyrën Speciale të prokurorëve të Kosovës, nën mbikëqyrjen e Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi. Kjo zyrë përfshinte gjashtë prokurorë specialë të Kosovës, me përqendrim në krime të rënda, përfshirë këtu trafikimin e personave, korrupsionin, dhe antiterrorizmin. Një prokuror special ishte përgjegjës për ndjekjen penale të trafikimit të personave, ndërsa një tjetër ishte përgjegjës për antiterrorizëm dhe krime të rënda ndëretnike.

IPVQ-ja përfshiu një zyrë qendrore të prokurorit publik, pesë prokurorë të qarkut, dhe shtatë prokurorë komunalë.

Ndonëse ligji parashikon që rastet e rënda të gjykohen nga një panel prej dy gjykatësve profesionalë dhe tre gjykatësve porotë, një rregullore e UNMIK-ut i autorizon prokurorët ndërkombëtarë që t'i gjykojnë rastet e natyrës së ndjeshme etnike ose politike, edhe para një paneli prej tre gjykatësve ndërkombëtarë. Që kur ia filluan punës, më 2003, prokurorët ndërkombëtarë kanë përfunduar përafërsisht 300 prej 700 rasteve që u ishin caktuar atyre.

Më 2006, UNMIK-u dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës filluan një fushatë rekrutimi për gjykatës dhe prokurorë që kishte për qëllim anëtarët e bashkësive të nënpërfaqësuar. Në qershor, një gjykatës serb i Kosovës dha betimin e zyrës, duke prurë numrin e përgjithshëm të gjykatësve serbë të Kosovës në 15.

Njësia e UNMIK-ut për Inspektim Gjyqësor (NJIGJ) vëzhgonte punën e gjyqësisë dhe bënte rekomandime rreth disiplinës dhe trajnimit. Kjo njësi ka mandat ta kontrollojë dhe vlerësojë sistemin gjyqësor të Kosovës, t'ia rekomandojë Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi zgjidhjen e problemeve sistematike, të kryejë hetime në pohimet për sjelljen e keqe gjyqësore dhe prokuroriale, dhe t'i paraqesë rastet e sjelljes së keqe në seanca disiplinore para Këshillit Gjyqësor të Kosovës. NJIGJ ka shqyrtuar gjithsej 1,838 ankesa që nga viti 2001, përfshirë këtu 351 ankesa prej fillimit të këtij viti deri në shtator. Prej këtyre 351 ankesave, njësia i kishte refuzuar 179 raste dhe i kishte përfunduar 71 prej 150 hetimeve. Në shumicën e hetimeve (64), njësia nuk konstatoi sjellje të keqe. Kjo njësi ia drejtoi gjashtë raste Këshillit Gjyqësor, i cili suspendoi një gjykatës komunal deri në marrjen e vendimit për pranim të ryshfetit, qortoi një prokuror të qarkut dhe një gjykatës komunal, dhe shfajësoi një gjykatës të qarkut dhe një prokuror të qarkut. NJIGJ u ankua për rastet e shfajësuar dhe kërkoi masa më të ashpra disiplinore për prokurorin.

Procedurat e gjykimit

Gjykimet janë publike, dhe ligji parashikon të drejtën e të pandehurve të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin dëshmitë, dhe të kenë përfaqësim ligjor, në shpenzime publike nëse është e nevojshme; megjithatë, këto procedura rrallë u përdorën në praktikë. Të pandehurit konsiderohen të pafajshëm derisa të mos shpallen fajtorë, dhe kanë të drejtë të ankohen. Gjykimet dëgjohen nga panelet e përbëra nga gjykatësit profesionalë dhe gjykatësit porotë; nuk ka gjykime me juri.

Që nga janari, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ua rriti pagën mujore avokatëve të caktuar nga gjykata prej përafërsisht \$365 (250 euro) në përafërsisht \$730 (500 euro) në muaj.

Gjatë këtij viti, IPVQ-ja themeloi një Komision për ndihmë juridike. Kryeministri caktoi drejtorin e komisionit, dhe Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi bëri kontrollimin e biografive të tetë kandidatëve për zëvendës të komisionit. Komisioni është agjenci e pavarur qeveritare që u ofron ndihmë juridike falas personave me të ardhura të ulëta. Sapo të bëhet plotësisht funksional, zyrtarët për ndihmë juridike do të punojnë në të pesë zyrat e qarkut për ndihmë juridike, ku avokatët e caktuar nga komisioni do t'u ofrojnë ndihmë juridike personave që kanë nevojë. Komisioni përdori një gamë të gjerë të mediave në përpjekje për ta inkurajuar pjesëmarrjen e pakicave.

Spektori për integrimin e gjyqësisë, i themeluar nga UNMIK-u, vazhdoi t'i shqyrtonte problemet e sistemit gjyqësor që ndikonin në pakica. Përveç kësaj, Ministria e Drejtësisë drejtonte 11 zyra ndërlidhëse të gjykatave, dy prej të cilave u themeluan gjatë këtij viti, për t'u ndihmuar bashkësive pakicë në zonat me shumicë serbe, duke i shoqëruar anëtarët e pakicave në gjykata, duke paraqitur dokumente në gjykata në emër të tyre, dhe duke siguruar informata dhe ndihmë ligjore për refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV). Si reagim ndaj kritikave të mëhershme nga ekspertët ligjorë dhe vëzhguesit e të drejtave të njeriut për mungesën e drejtësisë në

gjykimet penale ku përfshiheshin pakicat etnike, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë--e jo shqiptarë të Kosovës--i shqyrtonin dhe gjykonin rastet ku përfshiheshin serbët e Kosovës.

Sistemi i drejtësisë i Kosovës dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) vazhduan t'i identifikonin dhe dënonin autorët e krimeve të luftës nga konflikti i vitit 1999; megjithatë, shumë raste mbetën të pazgjidhura. Apelet e Gjykatës Supreme vazhduan në gjykata lokale për t'i gjykuar rastet e krimeve të supozuara të luftës dhe gjenocidit që rezultojnë nga konflikti i vitit 1999.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime që KFOR-i, UNMIK-u, SHPK-ja, apo IPVQ-ja mbanin të burgosur apo të arrestuar politikë gjatë këtij viti.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Sipas një raporti të OSBE-së të vitit 2006, ndërhyrja e autoriteteve komunale dhe e Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi e pengoi pavarësinë e gjyqësorit në çështje civile. OSBE-ja citoi raste në të cilat autoritetet komunale haptazi penguan procedurat gjyqësore, bënë presion në gjykatës në rastet në të cilat autoritetet ishin palë, dhe ndikuan në palët e treta për t'i penguar gjykatat nga ushtrimi i autoritetit të vet. OSBE-ja gjithashtu raportoi se Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi i udhëzoi gjykatësit të mos i shqyrtonin ankesat për kompensim për dëme pronësore të shkaktuara nga KFOR-i, UNMIK-u, apo komunat. Gjatë këtij viti, OSBE-ja raportoi se ishte arritur pak përparim në këtë aspekt, por jo i mjaftueshëm, për ta ulur numrin e rasteve të pazgjidhura. Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi pohoi se nuk kishte ushtruar ankesa të tilla për kompensim sepse sfidat logjistike të ankesave të tilla ishin të pakapërcyeshme. Ai gjithashtu pohoi se numri i madh i ankesave lidhur me pronën do të mund ta pengonte punën e gjykatave, ta shtonte numrin edhe kështu të madh të rasteve të pazgjidhura, dhe të kërkonte planifikim e koordinim të posaçëm, pasi do të ishte e domosdoshme të sigurohej përcjellje për një numër të madh të paditësve serbë të Kosovës. Në korrik, OSBE-ja raportoi se UNMIK-u dhe autoritetet komunale ndërhyjnë pavend në shitjen e propozuar të pronës në mëhallën e romëve në rajonin e Mitrovicës.

Nuk pati raportime për vështirësi në zbatimin e urdhrave të gjykatave që rezultojnë nga kontestet civile. Megjithatë, sipas një studimi të vitit 2006, vetëm 14 për qind e rasteve të pazgjidhura që ndikojnë në rendin civil rezultuan nga kontestet civile; 69 për qind e rasteve të tilla kishin të bënin me mbledhjen e borxhit nga kompanitë e shërbimeve publike.

Rikthimi i pronës

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) u themelua në mars 2006, në kuadër të IPVQ-së, si pasardhëse e Drejtorisë së UNMIK-ut për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB). Ndërsa drejtoria shqyrton vetëm ankesat e pronës rezidenciale, agjencia e re është përgjegjëse për zgjidhjen e ankesave për pronën rezidenciale, komerciale dhe bujqësore nga konflikti i Kosovës. Deri në shtator, agjencia kishte pranuar 27,064 ankesa: 24,064 për pronë bujqësore, 844 për pronë komerciale, dhe 1,808 për pronë rezidenciale. Serbët e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës vazhduan t'i zinin pronat e shqiptarëve, ndërsa shqiptarët në pjesën jugore ua zinin dhe ua mohonin serbëve qasjen në pronën e tyre.

Komisioni për çështje pronësore dhe banesore mbajti sesionin e vet të fundit në qershor, me ç'rast i shqyrtoi 53 kërkesa. Rreth 98.8 për qind e të gjitha vendimeve të komisionit ishin zbatuar, kishin mbetur vetëm 354 raste. Në fillim të gushtit, zëvendësi kryesor i PSSP-së përkohësisht suspendoi zbatimin e vendimeve të AKP-së për shkak të refuzimit të autoriteteve lokale në komunën e Klinës

për t'i zbatuar ato. Ky veprim nxiti bashkëpunim më të madh nga autoritetet komunale, dhe UNMIK-u hoqi këtë suspendim më 8 gusht; vlefshmëria e vendimeve të agjencisë së pronës ishte e paprekur.

Në fund të vitit, agjencia e pronës kishte 4,665 prona nën administrim, 3,350 me kërkesën e pretenduesit të suksesshëm, dhe 1,315 në bazë të ndërhyrjes *ex-officio* (për shkak të detyrës) nga Komisioni për çështje pronësore dhe banesore (agjenci paraardhëse e AKP-së). Prej këtyre rasteve, 167 ishin kërkesa për riposidim.

Mandati i AKP-së përfshin mbikëqyrjen e dhënies me qira të disa pronave të braktisura në Kosovë. Për këtë qëllim, agjencia menaxhoi një skemë të dhënies me qira për pronat që i kishte nën administrim, duke u mundësuar mbajtësve të pronave të pranonin të ardhura nga qiraja e pronës duke e autorizuar agjencinë ta lëshonte atë me qira derisa pronari të vendosë ta shfrytëzojë pronën në ndonjë mënyrë tjetër. Gjithsej 813 prona ishin të dhënë me qira në fund të vitit, 113 prej të cilave ishin lëshuar me qira *ex-officio*. AKP mbodhi përafërsisht \$618,330 (423,514 euro) nga qiraja përmes këtij programi.

Numri i pazgjidhur i ankesave pronësore në gjykata komunale mbeti i lartë, rreth 21,000 në fund të këtij viti, që paraqitnin pothuaj vetëm ankesa financiare të serbëve të Kosovës për dëme të lidhura me luftën.

f. Ndërhyrja arbitrare në intimitet, familje, shtëpi, apo korrespondencë

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese ndalojnë veprime të tilla, dhe UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi i respektuan këto ndalesa në praktikë. Forcat e KFOR-it i ndihmonin policisë civile të UNMIK-ut dhe SHPK-së në kryerjen e kontrollimeve për të dyshuar të rrezikut të lartë dhe në mënyrë të pavarur kontrollonin pronën private për armë, pa urdhër të gjykatës, duke u bazuar në autoritetin paqeruajtës të RKS KB-së 1244.

Seksioni 2 Respektimi i lirive civile, përfshirë këtu:

a. Lirinë e fjalës dhe të shtypit

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese parashikojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit, dhe UNMIK-u e IPVQ-ja në përgjithësi i respektuan këto të drejta në praktikë. Megjithatë, pati raportime për kërcënim ndaj gazetarëve, përfshirë këtu kërcënimin nga zyrtarët në sektorin publik e qeveritar, dhe nga politikanët e bizneset. Mediat gjithashtu thanë se hasën në vështirësi dhe pengesa me rastin e marrjes së informatave nga institucionet qeveritare dhe publike. Ligji në fuqi mbi mediat transmetuese ndalon fjalimin urrejtës dhe fjalimin që nxit dhunë etnike. Mediat e shkruara kanë një kod të etikës dhe një organ vetërregullues për t'i shqyrtuar ankesat lidhur me artikujt e gazetave.

Individët në përgjithësi mund t'i kritikonin autoritetet publikisht ose privatisht pa reprezalje.

Sipas Shoqatës së gazetarëve profesionistë të Kosovës, vështirësitë financiare të mediave bënë që pavarësia redaksionale dhe profesionalizmi gazetaresk t'i nënshtroheshin ndikimit dhe presionit të jashtëm. Disa gazeta ishin financiarisht të pavarura apo punonin përmes donacioneve ndihma dhe kështu ishin në gjendje të zhvillonin politika redaksionale të pavarura nga interesat afariste apo politike. Megjithatë, disa gazeta të tjera mbështeteshin në financim nga grupe afariste apo të interesit politik, të cilat siguronin para në shkëmbim për raportim pozitiv. Gjatë këtij viti, nuk pati raportime që IPVQ-ja apo UNMIK-u ushtruan presion apo ndikuan në mediat e shkruara të pavarura.

Mediat e shkruara vetërregulloheshin nga një kod i sjelljes për mediat e shkruara i miratuar nga Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, organizatë që përbëhet prej redaktorëve dhe botuesve të mediave të shkruara. Bordi i Këshillit për ankesa mund të imponojë gjopa për shkelje të kodit të sjelljes, përfshirë këtu gjopat deri në \$2,920 (2,000 euro) për shkelje të rënda, si fjalimi urrejtës dhe shpifja.

Gjatë këtij viti, Kosova kishte 114 transmetues të licencuar (45 prej tyre transmetonin në gjuhët e pakicave), dhe këta transmetues shprehnin një gamë të gjerë të pikëpamjeve.

Mediat ndërkombëtare u lejuan të vepronin lirisht.

Gazetarët raportuan se presioni nga politikanët dhe krimi i organizuar rezultoi në forma të tërthorta të censurimit; disa përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale. Gazetarëve nganjëherë u ofrohej kompensim financiar në shkëmbim për raportim pozitiv apo për heqje dorë nga ndonjë hetim. Sipas redaktorëve, agjencitë qeveritare i tërhiqnin reklamat e rregullta nga gazetatat që kishin raportuar në mënyrë kritike për to.

Që nga janari 2006, ndërmarrja publike transmetuese e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), është mbikëqyrur drejtpërdrejt nga Kuvendi i Kosovës, dhe buxheti i tij kontrollohej nga Ministria e Financave. Ligji i vitit 2006 mbi kalimin e mbikëqyrjes së RTK-së prej UNMIK-ut tek IPVQ-ja parashikon rregullimin e përmbajtjes së programit të RTK-së dhe kërkon që së paku 15 për qind e kohës së programit të RTK-së, përfshirë këtu kohën qendrore, t'u kushtohet bashkësive joshumicë në gjuhën e tyre përkatëse në baza proporcionale.

Në gusht 2006, Komisioni i pavarur për media e zëvendësoi komisionarin e përkohshëm të UNMIK-ut për media. Komisioni është organ i përhershëm i mbikëqyrur nga një këshill drejtues 7-anëtarësh që përfshin dy anëtarë ndërkombëtarë. Komisioni zbatoi rregulloret e UNMIK-ut dhe imponoi kodet e sjelljes që i drejtonin mediat transmetuese.

Viteve të mëparshme, emërimi publik i serbëve të Kosovës si kriminelë lufte rezultonte në vrasje vigjilente dhe dhunë tjetër. Që nga marsi, gazeta *Infopress* rregullisht botonte lista të serbëve të Kosovës që ishin pjesëtarë të ushtrisë jugosllave gjatë konfliktit të vitit 1998-99. Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës, një organ vetërregullues që merret me shqyrtimin e ankesave kundër mediave të shkruara, filloi një hetim por nuk mund të arrinte konsensus nëse *Infopress* kishte shkelur standardet e Këshillit të mediave të shkruara. OSBE-ja publikisht i kritikonte artikujt; *Infopress* e hidhte poshtë kritikën duke pohuar që artikujt e vet ishin të saktë dhe plotësonin një zbrazëti të lënë nga dobësia e gjyqësisë.

Për dallim nga viti 2006, këtë vit nuk pati raste të dhunës policore kundër gazetarëve. Megjithatë, Shoqata e gazetarëve profesionistë të Kosovës raportoi për 24 raste të abuzimit të lirisë së shtypit gjatë këtij viti. Aty përfshiheshin kërcënimet verbale ndaj gazetarëve dhe agjencive të tyre nga subjektet e prekura nga raportimi negativ i mediave, dhe presioni për të mos botuar materiale dhe artikuj të caktuar.

Gjatë këtij viti pati disa incidente të dhunës apo ngacmimit të drejtuara kundër mediave.

Më 6 mars, reporteri i *Lajmit*, Enis Veliu, pohoi të ishte sulmuar nga personeli i sigurimit të Kompanisë së Sigurimit WDG në selinë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në Prishtinë pasi e kishte pyetur zëdhënësen e KEK-ut për një tender për shërbime të sigurimit.

Më 21 shtator, shtëpia e gazetarit Milazim Zeka u dogj, duke rezultuar në dëme në vlerë prej rreth \$146,000 (100,000 euro). Zeka tha se shtëpia e tij ishte plaçkitur dy herë para këtij incidenti. Zeka kishte shkruar raporte për rastet kontroverze, përfshirë këtu vrasje të profilit të lartë dhe korrupsion.

Më 2 gusht, Shoqata e gazetarëve profesionistë të Kosovës pranoi një ankesë nga reporteri i *Lajmit*, Alban Selimi, i cili pohonte se Ministria e Shëndetësisë ia kishte mohuar hyrjen fizike në ministri dhe qasjen në informata të ministrisë si hakmarrje për botimin e një raporti për të cilin ministria pohonte të ishte i pasaktë.

Në korrik, reporterët e të përditshmes *Koha Ditore* u ankuan publikisht se Ministria e Mjedisit ua kishte ndaluar hyrjen në Ministri, gjoja për shkak të kundërshtimit të një deklaratë të ministrit.

Ndryshe nga vitet e mëparshme, nuk pati raportime për grindje ndërmjet gazetarëve dhe pjesëtarëve të SHPK-së.

Nuk pati zhvillime në hetimin e vrasjes më 2005 të redaktorit të gazetës *Bota Sot*, Bardhyl Ajeti. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Sipas rregulloreve mbi zgjedhjet, mediat duhet t'u sigurojnë të gjitha partive mbulim dhe qasje të drejtë dhe të paanshme në diskutime dhe debate gjatë fushatave politike; raportimi lidhur me fushatën duhet të jetë i drejtë dhe i paanshëm; dhe debatet duhet të kenë mysafirë dhe audiencë të ndryshme politike dhe moderatorë të paanshëm. Më 2006, një gjykatës ndërkombëtar urdhëroi që pasuritë e të përditshmes *Bota Sot* të konfiskoheshin dhe shiteshin për ta paguar gjobën prej \$105,000 (72,000 euro) për mbulim të çekuilibruar të zgjedhjeve të vitit 2004 dhe dështimit për të siguruar saktësi gjatë raportimit. Një xhirrollogari e gazetës *Bota Sot*, që kishte \$75,900 (52,000 euro) u ngri deri në pagesën e gjobës. Nuk pati zhvillime në këtë rast, dhe llogaria bankare mbeti e ngrirë. *Bota Sot* filloi të botohej sërish në mars pasi gazeta kishte arritur një marrëveshje me Administratën Tatimore për pagesë graduale të borxhit të vet.

Liria e internetit

UNMIK-u, KFOR-i apo IPVQ-ja nuk e kufizonin qasjen në internet, dhe nuk pati raportime që qeveria i vëzhgonte e-mailat apo bisedat në internet. Individët dhe grupet mund të angazhoheshin në shprehje paqësore të mendimeve përmes internetit, përfshirë këtu e-mailat. Në një sondazh të kryer në maj, rreth 22 për qind e kosovarëve thanë se internetin e përdornin përditë.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

UNMIK-u, KFOR-i apo IPVQ-ja nuk e kufizonin lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e grumbullimit paqësor dhe grupimit

Liria e grumbullimit

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese parashikojnë lirinë e grumbullimit, dhe UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë. Një rregullore e UNMIK-ut kërkonte që organizatorët e demonstratave ta njoftonin policinë 48 orë më parë për qëllime të koordinimit.

Sipas raporteve të mediave, SHPK-ja përdori forcën për t'i shpërndarë demonstratat dhe rrahu demonstruesit gjatë arrestimit në së paku katër raste gjatë këtij viti.

Liria e grupimit

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese parashikojnë lirinë e grupimit, dhe UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë.

Misioni i OSBE-së në Kosovë rregullisht i regjistronte partitë politike nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, dhe Ministria e Shërbimeve Publike i regjistronte OJQ-të.

c. Liria e fesë

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese parashikojnë lirinë e fesë, dhe UNMIK-u e IPVQ-ja në përgjithësi e respektuan këtë të drejtë në praktikë.

Nuk ka rregullore specifike për licencimin e grupeve fetare; megjithatë, organizatat fetare duhet të regjistrohen si OJQ në UNMIK dhe në Ministrinë e Shërbimeve Publike për të blerë pronë ose për të marrë mjete financiare nga UNMIK-u apo organizatat e tjera ndërkombëtare. Grupet fetare ankoheshin se statusi i OJQ-së nuk e pasqyrore në mënyrë adekuate karakterin e tyre fetar, dhe Kisha protestante evangjelite refuzoi të regjistrohej si OJQ.

Në përputhje me një ligj të vitit 2002, i cili kërkon që institucionet publike të arsimit të përmbahen nga udhëzimet fetare apo aktivitetet e tjera që mbështesin ndonjë fe specifike, Ministria e Arsimit ndaloi mbajtjen e shamive. Ministria vazhdoi ta zbatonte këtë ndalesë, posaçërisht në shkolla ku veshja e uniformës ishte e detyrueshme, përkundër një mendimi të vitit 2004, të lëshuar nga ombudspersoni, se ai rregull duhet të zbatohet vetëm për mësimdhënës e nëpunës të shkollës, e jo për nxënës. Më 20 shtator, *Koha Ditore* raportoi se tri nxënëseve u ishte ndaluar hyrja në dy shkolla të mesme në komunën e Skenderajt pasi kishin veshur shami; më në fund, ato u lejuan ta vijonin mësimin.

Grupet protestante vazhduan të raportonin se përjetonin diskriminim në qasje në media, posaçërisht nga RTK-ja. Kisha protestante evangjelite në Kosovë, e njohur si Bashkësia e Popullit të Zotit, raportoi më 2006 se komuna e Deçanit, duke cituar reagime negative nga qytetarët lokalë, nuk i kishte dhënë leje për ta ndërtuar një objekt kishitar në tokën që kisha e kishte blerë më herët. Në fund të vitit, rasti mbeti të zgjidhej në Gjykatën Supreme.

Bashkësia islame vazhdoi të pohonte se refuzimi i UNMIK-ut për frekuenca për një radiostacion islamik dhe mbyllja e një salle për falje në Bibliotekën Kombëtare përbënin shkelje të lirisë së fesë.

Abuzimi dhe diskriminimi shoqëror

Pati raportime për sulme kundër klerikëve ortodoksë serbë dhe pjesëtarëve të famullisë dhe raste të shumta të vandalizmit të kishave ortodokse serbe dhe të pronës së kishave.

Nuk pati zhvillime në rastin e majit 2006 në të cilin sulmues të panjohur shtinë në veturën që e ngjiste prifti ortodoks serb Sërxfan Stanković në komunën e Zveçanit. UNMIK-u akuzoi një polic serb të SHPK-së lidhur me këtë incident. Rasti iu dorëzua një prokurori ndërkombëtar dhe mbeti i pazgjidhur deri në fund të vitit.

Pati raportime për incidente të hedhjes së gurëve dhe për sulme të tjera kundër autobusëve serbë dhe klerikëve ortodoksë serbë gjersa udhëtonin jashtë manastireve të tyre, dhe murgjit e murgeshat në disa manastire gjoja nuk i shfrytëzonin disa pjesë të pronave të manastireve për shkak të brengave për sigurinë e tyre.

Brengat e sigurisë vazhduan të ndikonin në bashkësinë serbe dhe në lirinë e tyre për t'u falur. Disa serbë të Kosovës pohuan se nuk ishin në gjendje të udhëtonin lirisht për ta ushtruar besimin e tyre.

Më 29 mars, një sulmues, të cilin SHPK-ja e identifikoi si Jusuf Mulaj nga fshati Isnqi, shtiu me mortajë dore në manastirin e Deçanit. Kryeministri Agim Çeku dhe politikanë të tjerë të lartë shqiptarë të Kosovës e dënuan sulmin dhe shprehën solidaritet me manastirin. Policia bastisi shtëpinë e Mulajt më 4 maj, por ai ishte larguar, që sugjeron se ka të ngjarë që dikush e kishte paralajmëruar për këtë bastisje. Ky ishte sulmi i katërt kundër manastirit që nga viti 1999. Mulaj mbeti në liri në fund të vitit.

Më 29 korrik, në fshatin Boletin, komuna e Zveçanit, një shqiptar i Kosovës kërcënoi një murgeshë ortodokse serbe nga manastiri i Sokolicës. Sulmuesi e ofendoi murgeshën dhe iu kërcënua edhe një ushtari të KFOR-it me sëpatë. Autori u ndalua nga SHPK-ja për hetime dhe më vonë u lirua.

Gjatë këtij viti pati raste të shumta të vandalizmit dhe vjedhjes të drejtuara kundër pronës së kishës ortodokse serbe. Shumë raste përfshinin vjedhje të objekteve të punuara nga metalet e çmuara, ndërsa të tjerat përfshinin vandalizmin, shpesh të kishave të saponëduara. Më 5 mars, p.sh., persona të panjohur vandalizuan kishën e Shën Gjoni në Pejë. Shën Gjoni ishte një prej shumë kishave të djegura në trazirat e vitit 2004 dhe pjesërisht e rindërtuar më 2005.

Më 16 janar, peshkopi Teodosije i Lipjanit dhe anëtar i Komisionit të Këshillit të Evropës për meremetimin e kishave në Kosovë vizitoi kishën e saponëmeretuar të Shën Nikollës në Prishtinë pasi komisioni ishte njoftuar se një pjesë e pullazit mungonte. Përveç vjedhjes së pullazit, ishin thyer edhe disa dritare të kishës.

Më 10 shkurt, persona të panjohur dëmtuan interierin e kishës ortodokse në fshatin Lepi, komuna e Lipjanit, dhe vodhën rreth \$560 (30,000 dinarë serbë). SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Më 30 maj, pesë adoleshentë u arrestuan pasi e larguan pullazin e plumbtë të kishës së Djellës së Shenjtë në Prizren. Këta adoleshentë u liruan pas pak kohësh.

Më 18 gusht, persona të panjohur shkruan me grafiti brenda një kishë ortodokse serbe në Gjilan, tekstin, që ndër të tjera thoshte: “Jam krenar që jam shqiptar” dhe “Vdekje të gjithë serbëve”. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Më 26 tetor, Komisioni i Këshillit të Evropës për zbatimin e rindërtimit, i cili mbikëqyr rindërtimin e kishave ortodokse serbe të shkatërruara gjatë trazirave të marsit 2004, raportoi se hajnat kishin vjedhur rreth \$15,000 (10,400 euro) nga kisha e Djellës së Shenjtë dhe kisha e Shën Premtes, të dyja në rindërtim e sipër në Prizren. IPVQ-ja publikisht i dënoi vjedhjet dhe u zotua t'i financonte meremetimet. IPVQ-ja më vonë zotoi rreth \$70,000 (50,000 euro) në një përpjekje për të ofruar siguri në vendet e komisionit për rindërtim.

Një grup protestant në Mitrovicë raportoi për incidente të rregullta e sistematike të vandalizmit dhe vjedhjes në kishën e tyre. Grupi raportoi se SHPK-ja dështoi të merrte masa, përkundër ekzistimit të video dëshmive për krime dhe informatave për autorët e krimit.

Përkundër disa përmirësimeve, protestantët vazhduan të raportonin për ngacmim dhe diskriminim, përfshirë këtu sulmet verbale, mungesën e programit për protestantë në RTK, dhe incidentet e zyrtarëve të shkollave të cilët i thërrisnin prindërit e nxënësve për t'i penguar fëmijët e tyre për t'u kthyer në protestantizëm.

Rreth 40 individë nga dy familje në Prizren kishin ca zanafillë hebraike, por nuk pati sinagoga apo institucione hebraike në Kosovë, përveç një varreze të vogël në Prishtinë. Më 16 gusht, 14 gurë të varrezave ishin dëmtuar me qëllim. Policia vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Për diskutim më të hollësishëm, shih *Raportin ndërkombëtar të vitit 2007 mbi lirinë e fesë*.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit,

Mbrojtja e refugjatëve, dhe e personave pa shtetësi

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese parashikojnë lirinë e lëvizjes brenda Kosovës, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe UNMIK-u e IPVQ-ja në përgjithësi i respektuan këto të drejta; megjithatë, tensionet ndëretnike dhe brengat e vërteta dhe të perceptuara të sigurisë e kufizonin lirinë e lëvizjes në praktikë. Gjatë këtij viti, UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi e përmirësuan mbrojtjen e këtyre të drejtave për bashkësitë pakicë. IPVQ-ja bashkëpunoi me zyrën e OKB-së për Refugjatë (UNHCR) dhe me organizata të tjera humanitare për t'u ofruar mbrojtje dhe ndihmë personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve, refugjatëve që ktheheshin, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe personave të tjerë të interesuar.

Policia vazhdoi ta vlerësonte situatën e sigurisë si stabile, por delikate. Policisë nuk iu raportua për krime që kishin të bënin me lirinë e lëvizjes. Megjithatë, anëtarët e të gjitha bashkësive etnike vazhduan të qëndronin kryesisht brenda apo të udhëtonin ndërmjet zonave në të cilat grupi i tyre përbënte shumicën. Hedhja e gurëve dhe forma të tjera të kërcënimit vazhduan të ndikonin në serbët e Kosovës gjersa udhëtonin jashtë zonave me shumicë serbe.

Incidentet sporadike të dhunës dhe të kërcënimit që synonin pakicat vazhduan ta kufizonin lirinë e lëvizjes për shqiptarët në Kosovën veriore. IPVQ-ja dhe UNMIK-u i shtuan përpjekjet për ta lehtësuar udhëtimin e pakicave në mbarë Kosovën, por rreziqet e vërteta dhe të perceptuara i frenonin shumë pakica që të udhëtonin jashtë lagjes së tyre.

Më 27 qershor, SHPK-ja në komunën e Laposaviqit me shumicë serbe u alarmua për një eksplozim në rrugën që shpie për në fshatrat shqiptare Koshtovë, Bisticë dhe Cerajë. Një minibus, i drejtuar nga zyra komunale për bashkësi, ishte duke i transportuar nëntë udhëtarë dhe shkeli në telin e lidhur për një granatë dore, e cila eksplodoi prapa veturës. Nuk pati të lënduar nga ky eksplozim. Ky ishte mjeti i dytë shpërthyes i vendosur në rrugë brenda dy muajve; në incidentin e parë, KFOR-i zbuloi dhe çmontoi një bombë. Hetimi lidhur me këtë rast vazhdoi deri në fund të vitit.

Gjatë këtij viti pate sulme kundër autobusëve që bartnin serbë dhe pakica të tjera etnike. Më 14 tetor, p.sh., autobusi që transportonte një grup të serbëve që e vizitoi Patriarkanën ortodokse serbe në Pejë u gjuajt me gurë gjatë vizitës në manastirin e Deçanit. Thuhej që autobusit iu shkaktuan dëme të mëdha. Më 17 nëntor, një autobus që transportonte 30 studentë dhe profesorë nga Seminari Teologjik i Varshavës për në manastirin e Zoçishtës u gjuajt me gurë gjersa ishte i parkuar në mes të një fshati me shumicë shqiptare.

Për ta ulur rrezikun nga sulmi, duke i bërë automjetet e serbëve dhe të shqiptarëve të padallueshme nga njëra-tjetra, UNMIK-u vazhdoi t'u ofronte targa të Kosovës pa pagesë serbëve që i kishin regjistruar automjetet e veta në Serbi. Megjithatë, serbët e Kosovës ngurrnin t'i përdornin targat e lëshuara nga UNMIK-u sepse një gjë e tillë ua kufizonte mundësinë e tyre për të udhëtuar për në Serbi, e cila nuk i njeh targat e UNMIK-ut.

Gjithashtu pati incidente që kishin në shënjestër infrastrukturën që shfrytëzohej nga pakicat. Më 10 mars, gjahtarët gjetën një granatë të pashpërthyer afër një transmetuesi në fshatin Maticë në

Mitrovicë. Më 17 prill u gjet një mjet shpërthyes në një urë në fshatin Pogragjë në Gjilan. Më 23 prill, një mjet i pashpërthyer u gjet nën një urë në fshatin Vërboc në Gjilan. Deri në fund të vitit nuk u arrestua asnjë i dyshuar për këto incidente.

Nuk pati zhvillime në këto raste nga viti 2006: zbulimi në qershor i eksplozivit nën një urë që lidh dy fshatra me serbë të kthyer në komunën e Klinës, dhe shpërthimi në dhjetor në hekurudhën në fshatin Mihaliq, komuna e Vushtrrisë, që përkohësisht ndërpreu shërbimin e qarkullimit të trenit ndërmjet bashkësive serbe në Kosovën jugore dhe zonave në veri të lumit Ibër. Nuk u arrestua asnjë i dyshuar për këto incidente

Më 1 janar, UNMIK-u ua kaloi përgjegjësitë për shërbime të transportit humanitar dhe special për bashkësitë pakicë në Kosovë Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit dhe Ministrisë për Kthime dhe Bashkësi. Disa serbë të Kosovës u ankuan se cilësia dhe frekuenca e shërbimeve të transportit humanitar në disa komuna ishte pakësuar pas këtij kalimi.

UNMIK-u rregullonte lëvizjen brenda Kosovës dhe jashtë saj. Rregulloret e UNMIK-ut parashikojnë që zyra qendrore e regjistrimit civil mund t'i lëshojë dokumente të udhëtimit cilitdo individ të regjistruar si banor i Kosovës, dhe zyra rregullisht lëshonte dokumente të tilla në praktikë. IPVQ-ja mbante përgjegjësitë drejtuese dhe operative për zyrën e regjistrimit civil, ndërsa UNMIK-u mbante autoritetin e vet të përgjithshëm, përfshirë këtu lëshimin e dokumenteve të UNMIK-ut për udhëtim dhe sigurinë për bazën qendrore të regjistrimit të të dhënave.

Ligji ndalon dëbimin me forcë, dhe autoritetet nuk e përdorën atë.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Sipas UNHCR-së, rreth 207,000 persona nga Kosova mbetën të zhvendosur në Serbi dhe 16,500 në Mal të Zi si rrjedhojë e konfliktit të vitit 1998-99. Prej 4,100 personave të zhvendosur gjatë trazirave të marsit 2004, nja 1,200 mbetën të zhvendosur. 20,310 persona ishin të zhvendosur brenda Kosovës, pothuaj gjysma e tyre ishin shqiptarë të Kosovës. Pak PZHBV u kthyen gjatë këtij viti për shkak të pasigurisë mbi statusin e ardhshëm politik të Kosovës, mungesës së mundësive për punësim, brengave të sigurisë dhe kontesteve pronësore. Kthimet e suksesshme vazhduan në Klinë, Istog dhe Pejë. Ndonëse qeveritë komunale në përgjithësi i mbështetën kthimet, pengesat për kthimin e serbëve në Kosovë ngelën.

Gjatë këtij viti, numri i kthimit të pakicave mbeti i ulët, ndonëse pati një rritje në kthimin e romëve, ashkalinjve dhe të ashtuquajturve egjiptianë të Kosovës. Kthimi i serbëve të Kosovës mbeti i ulët. Sipas UNHCR-së, më tepër PZHBV u kthyen në Kosovë gjatë këtij viti sesa më 2006, duke ndryshuar kështu trendin në rënie e sipër të kthimeve në vit që nga viti 2003. UNHCR-ja raportoi se 1,685 anëtarë të pakicave ishin kthyer gjatë këtij viti, ndërsa në vitin 2006 ky numër ishte 1,627. Këtu përfshihet edhe kthimi i shqiptarëve të Kosovës në zonat ku ata ishin pakicë.

Gjatë këtij viti, UNMIK vazhdoi kalimin e kompetencave tek Ministria për Kthime dhe Bashkësi. Kompetencat e bartura përfshinin koordinimin e financimit në pjesë të barabarta për komuna dhe koordinimin e punës e zyrave komunale për kthim dhe të zyrave komunale për bashkësi. Ministria i përqendroi përpjekjet e veta në mbështetjen e kthimit të organizuar dhe individual të pakicave dhe në administrimin e projekteve për zhvillimin dhe stabilizimin e bashkësisë.

Prej vitit 2000 e deri në shtator ishin kthyer gjithsej 17,149 anëtarë të pakicave. Serbët përbënin rreth 38 për qind të të kthyerve gjatë këtij viti, krahasuar me 31 për qind më 2006. Romët (përfshirë këtu ashkalinjtë dhe egjiptianët) vazhduan të ktheheshin në numër pak më të madh, dhe përbënin 43 për qind të numrit të përgjithshëm të të kthyerve, krahasuar me 54 për qind më 2006. Në Mitrovicë,

serbët në veri të qytetit dhe shqiptarët në jug vazhduan ta zinin në mënyrë të paligjshme pronën e njëri-tjetrit, duke i penguar kthimet e mundshme.

Që nga shtatori, qeveria kishte rindërtuar mbi 98 për qind (881 prej 897) të shtëpive të dëmtuara apo të shkatërruara në trazirat e marsit 2004. Sipas Ministrisë së Kulturës, prej 26 shtëpive të parindërtuara, 23 mbetën të papërfunduara për shkak të brengave të sigurisë në Mitrovicën veriore, dhe pronarët e tri shtëpive të tjera refuzuan rindërtimin e shtëpive të tyre. Më 11 maj, pas ankesave për cilësinë e rindërtimit, qeveria themeloi një komision pesë-anëtarësh për shqyrtimin e ankesave, ndonëse ky organ nuk kishte filluar të lëshonte vendime deri në fund të vitit.

Që nga shtatori, 37 familje romë (114 persona) mbetën në kampin për PZHBV në Llugë, të ndotur me plumb. Osterode, një objekt për trajtim mjekësor, gjithashtu në Mitrovicën veriore, strehonte 98 familje (395 persona) që u zhvendosën nga kampi i Llugës dhe kampe të tjera të ndotura më 2006. Gjatë këtij viti, 31 fëmijë në Osterode filluan trajtimin për helmim nga plumbi dhe 20 të tjerë filluan fazën e dytë të trajtimit.

Më 2005, UNMIK-u filloi një fushatë për ndihmë financiare nga donatorët për ta rindërtuar mëhallën e romëve në Mitrovicën jugore, të shkatërruar më 1999 nga shqiptarët. Mjetet e kufizuara financiare ngadalësuan projektin për kthime, por rindërtimi i mëhallës filloi në maj 2006. Kthimi në këtë mëhallë filloi më mars dhe deri në fund të vitit ishin kthyer 320 prej 438 personave që priteshin të ktheheshin. Rindërtimi i dy ndërtesave të tjera për strehim me 24 njësi banimi përfundoi dhe 24 familje u vendosën në to deri në fund të vitit. Në mars, SHPK-ja hapi një nënstacion policor në këtë zonë, dhe një klinikë shëndetësore, e mbështetur nga një qeveri e huaj, u hap në maj.

Mbrojtja e refugjatëve

Ligji nuk parashikon dhënien e statusit të azilantit apo të refugjatit sipas Konventës së vitit 1951 lidhur me statusin e refugjatëve apo të Protokollit të saj të vitit 1967. Megjithatë, Kosova jep statusin e azilantit dhe refugjatit sipas një rregulloreje të UNMIK-ut për qarkullimin e personave brenda Kosovës dhe jashtë saj, dispozitat e të cilës janë në përputhje me këtë Konventë dhe Protokoll. Sipas mandatit të vet, UNMIK-u lëshon vendime për raste të tilla në Kosovë.

Në praktikë, UNMIK-i siguron mbrojtje kundër “dëbimit,” kthimit të personave në vendin ku ka arsye të besohet se ata i frikoheshin ndjekjes penale.

Seksioni 3 Respektimi i të drejtave politike: e drejta e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre

Rregulloret e UNMIK-ut dhe Korniza Kushtetuese parashikojnë të drejtën e qytetarëve për ta ndërruar qeverinë e tyre në mënyrë paqësore, dhe ata e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike në bazë të votimit të përgjithshëm.

Kosova vazhdoi të administrohej nën autoritetin civil të UNMIK-ut. UNMIK-u dhe kryeadministratori i tij, PSSP, themeluan një administratë civile ndërkombëtare më 1999, pas përfundimit të fushatës ushtarake të NATO-së, që i detyroi forcat serbe të tërhiqeshin. Më 2001, UNMIK-u shpalli Kornizën Kushtetuese për IPVQ-në. Sipas kësaj Kornize, Kuvendi 120-anëtarësh i Kosovës zgjedh kryetarin, kryeministrin dhe ministrat e zyrtarët e tjerë të IPVQ-së. Udhëheqësit e Kosovës vazhduan ta kritikonin UNMIK-un për hapin e ngadalshëm të kalimit të kompetencave tek IPVQ-ja, dhe UNMIK-u mbajti një numër të kompetencave në bazë të Rezolutës 1244 të KSKB-së, përfshirë këtu sigurinë dhe marrëdhëniet me qeveritë e huaja. Më 2005, një raport i OKB-së theksoi se pa qartësi për statusin e ardhshëm politik, IPVQ-ja nuk mund të ndërmerre hapa të tjerë për ta përmirësuar efikasitetin e vet.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendës konstatuan se zgjedhjet e 17 nëntorit për Kuvend të Kosovës në përgjithësi pasqyruan vullnetin e votuesve, ndonëse pak serbë të Kosovës morën pjesë në to, kryesisht për shkak të presionit të qeverisë serbe për t'i bojkotuar zgjedhjet. Nuk u raportuan parregullsi të mëdha. Kosova ka një sistem shumëpartiak të dominuar nga katër parti shqiptare me disa parti e koalicione të pakicave.

Sipas rregulloreve të UNMIK-ut, individët mund ta propozojnë veten si kandidatë të partive të tyre, të cilat duhet të mbajnë zgjedhje të brendshme, të hapura e transparente, për t'i zgjedhur listat e kandidatëve. Lidhja partiake luante rol të rëndësishëm në qasje në shërbime sociale dhe në mundësi për punësim. Marrëveshjet tradicionale shoqërore dhe besnikëritë klanore gjithashtu luanin rol të rëndësishëm, ndonëse jozyrtar, në organizatat politike.

Pati raportime për sulme dhe kërcënime me motive politike ndaj personaliteteve politike e institucionale të shqiptarëve të Kosovës gjatë këtij viti.

Në shkurt, pas një vendimi mbi tenderin për telefoninë e dytë mobile në Kosovë, dy persona të panjohur shtinë në Anton Berishën, shef i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, gjersa udhëtonte në magjistralen Prishtinë-Pejë; nuk u raportua për të lënduar. Të dyshuarit gjithashtu e sulmuan Berishën nga pusia në fshatin Balancë afër Klinës më 12 prill; një polic i SHPK-së u lëndua gjatë këtij sulmi. Më 23 korrik, prokurori special, Afrim Shefkriu, ngriti aktakuzë kundër pesë të dyshuarve. Më 17 shtator, Agim Hoti, njëri prej të dyshuarve, pranoi të kishte shtënë në drejtim të veturës, por pohoi se nuk kishte për qëllim ta vriste Berishën. Ai gjithashtu pranoi se armët e përdorura në këtë sulm dhe armët e gjetura gjatë hetimit të policisë ishin të tij dhe se ai i përdorte ato në mënyrë të paligjshme. Katër të dyshuarit e tjerë nuk e pranuan fajin.

Nuk pati zhvillime në këto raste të vitit 2006: sulmi, në janar, nga një person i panjohur kundër anëtarit të kryesisë së degës së LDK-së në Ferizaj, Ismajl Nazifi; botimi në korrik nga një gazetë ditore e Kosovës, i një kërcënimi kundër ekipit negociator të Kosovës nga të vetëquajturit "bashkëluftëtarët e Karadakut"; dhe sulmi me bombë ndaj veturës që i takonte bashkëshortes së ish-ministrit të Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepi.

38 femra ishin në Kuvendin 120-anëtarësh të Kosovës. Femrat duhet ta zënë çdo të tretin vend në listën e kandidatëve të secilës parti politike. Nuk pati asnjë femër në kryesinë 8-anëtarëshe të Kuvendit, dhe vetëm një femër ishte ministre dhe një zëvendësministre. Femrat përfaqësonin 28 për qind të përfaqësuesve të zgjedhur komunalë. Në shtator 2005, 34 anëtare të Kuvendit të Kosovës formuan një grup parlamentar jozyrtar të femrave me një bord shumetnik 8-anëtarësh.

Pas zgjedhjeve të 17 nëntorit, 24 anëtarë të pakicave etnike ishin në Kuvendin 120-anëtarësh të Kosovës, përfshirë këtu 10 serbë dhe 14 anëtarë të grupeve të tjera, përfshirë këtu turqit, boshnjakët, goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Tre ministra nga pakicat--dy serbë dhe një boshnjak--dhe një zëvendësministër serb ishin në IPVQ. Vendi i një ministri serb mbeti i lirë, pasi partia e caktuar serbe refuzoi ta merrte postin. Një boshnjak dhe një turk mbanin një vend me rotacion në kryesinë e Kuvendit të Kosovës; bojkotimi i njëriës nga partitë serbe të Kosovës i la të zbrazëta të tetë vendet e vëna mënjane për serbët e Kosovës. Serbët nga disa parti politike i fituan të 10 vendet e vëna mënjane në Kuvend në zgjedhjet e 17 nëntorit. Para atyre zgjedhjeve, mbajtësit e mëparshëm të atyre vendeve nuk i kërkuan postet e tyre të vëna mënjane në kabinet dhe vazhduan t'i bojkotonin votimet e Kuvendit, ndonëse merrnin pjesë në komisione. Një serb i Kosovës udhëhoqi Ministrinë për Kthime. Korniza Kushtetuese kërkon që Kuvendi t'i rezervojë 10 vende për serbët e Kosovës dhe 10 për anëtarët e grupeve të tjera etnike, por pakicat etnike ishin të nënpërfaqësuar në nivelin komunal, ku dispozitat e tilla nuk qeverisin.

Korrupsioni dhe transparencë qeveritare

Pati perceptim të gjerë publik për korrupsion në IPVQ dhe UNMIK. Indikatorët e Bankës Botërore për qeverisje në botë pasqyronin që korrupsioni ishte problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive ndaj gjyqësorit dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuan korrupsionit në IPVQ. Si pjesë e mandatit të vet, UNMIK-u vazhdoi t'i gjykonte shumë raste të ndjeshme që kishin të bënin me korrupsion dhe krime ndëretnike.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, një organ i pavarur mbikëqyrës, kontrolloi menaxhimin dhe përgjegjësinë financiare të IPVQ-së, si dhe të të gjitha komunave dhe ndërmarrjeve publike. Gjatë këtij viti, zyra lëshoi raporte të auditimit për secilën ministri, për zyrën e Presidentit, dhe për Kuvend. Shumica e raporteve kritikonin menaxhimin administrativ dhe fiskal të qeverisë, dhe praktikën e prokurimit.

Gjatë këtij viti, prokurorët vazhduan t'i kontrollonin raportet e auditimit nga viti 2006, që shpuren në dorëheqjen e ish-ministrit për kthime Sllavisa Petković.

Më 2006, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, urdhëroi një auditim mbi menaxhimin e Kuvendit gjatë kohës së paraardhësit të tij, Nexhat Daci. Auditimi zbuloi keqëbërje dhe keqadministrime të shumta nga administrata e Kuvendit, keqpërdorim të fondeve publike, dhe parregullsi në prokurim gjatë mandatit të Dacit. Kuvendi më pas ngriti një komision për ta hetuar këtë çështje. Më 17 janar, si rezultat i punës së vet, komisioni pushoi nga puna katër anëtarë të Kuvendit për keqëbërje gjatë kryesisë së Dacit. Më 22 shkurt, Kuvendi debatoi dhe mbështeti një raport të auditorit të përgjithshëm, i cili vinte në pah krime në Kuvend gjatë udhëheqjes së Dacit.

Në qershor 2006, Njësia e SHPK-së për hetimin e krimeve financiare dhe të korrupsionit e arrestoi Ahmet Alishanin, këshilltar i lartë i Dacit, nën dyshimin për mashtrim dhe rryshfet. Alishani u lirua, por ai u arrestua sërish në nëntor 2006 në lidhje me auditimin në Kuvendin e Kosovës. Alishani u lirua më 1 shkurt deri në fillimin e gjyqimit.

IPVQ-ja ndërmori hapa të tjerë për ta luftuar korrupsionin. Agjencia e sapoformuar kundër Korrupsionit filloi punën në shkurt. Më 7 qershor, drejtori i agjencisë, Hasan Preteni, tha se institucionet e qeverisë nuk e mbështetnin sa duhet as Agjencinë kundër Korrupsionit as luftën kundër korrupsionit. Më 5 shtator, Preteni njoftoi se agjencia ia kishte dorëzuar zyrës së prokurorit 37 raste për korrupsion.

Nuk pati zhvillime në hetimin e sulmit në shkurtit 2006 kundër auditores së përgjithshme të pavarur ndërkombëtare, që ndodhi pak kohë pasi e kishte lëshuar një auditim kritik për komunën e Prishtinës. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Në nëntor 2006, një prokuror ndërkombëtar paditi ish-drejtorin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Leme Xhema; ish-menaxherin e divizionit në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Roger Reynolds; ish-drejtorin e Norway Invest-it, Mustafa Neziri; dhe ish-drejtorin menaxhues e kryetar i Norway Invest-it, Ronnen Sorensen, lidhur me keqpërdorimin e supozuar të \$438,000 (300,000 euro). Më 5 prill, Ove Johansen, shtetas norvegjez, u arrestua në Mal të Zi në bazë të një urdhër arresti ndërkombëtar të lëshuar nga UNMIK-u në nëntor 2006; thuhej që Johansen kishte rregulluar bartjen e këtyre mjeteve nga PTK-ja tek një kompani fantazmë me seli në Norvegji. Johansen mbeti në burg deri në fund të vitit, dhe rasti i tij penal pritej të gjykohej.

Më 4 maj, prokurori i Pejës, Gëzim Kollçaku, konfirmoi hetimin e 11 nëpunësve ndërkombëtarë dhe të 8 nëpunësve vendës të Hidro-Sistemit Radoniqi, një ndërmarrje që kishte marrëveshje me

KEK-un. Ish-menaxheri i KEK-ut, Joe Truschler, i dënuar më 2003 në Gjermani për vjedhjen e \$6.6 milionë (4.5 milionë euro) nga KEK-u, ishte shef i bordit të Radoniqit para se ta merrte postin në KEK, dhe gjithashtu ishte i implikuar në hetimin e Radoniqit. Sipas Kollçakut, shqetësimet lidhur me krimin e organizuar kërkuan që ky rast t'i dorëzohej zyrës së prokurorit special.

Më 14 maj, një panel i përzier, i përbërë prej dy gjykatësve ndërkombëtarë dhe një gjykatësi vendës, e shpalli fajtoresh Teuta Vranicën, gjykatëse e gjykatës komunale në Gjakovë, për zhvatje dhe shkatërrim të dokumenteve zyrtare. Vranica kishte kërkuar që një palë në një çështje civile t'ia paguante asaj \$730 (500 euro) si shpërblim për vendimin e favorshëm, më pas ajo shkatërroi aktakuzën e prokurorit publik dhe dosjen. Asaj iu shqiptua dënimi prej 3.5 vjetësh, dhe iu ndalua të punonte si gjykatëse pesë vjet pas mbarimit të dënimit të saj.

Në nëntor 2006, dy zyrtarë financiarë të Burgut të Dubravës u arrestuan nën akuzat për keqpërdorim të postit zyrtar dhe falsifikim të dokumenteve. Shefi i financave, Sabajdin Llonqari, dhe ndihmësi i prokurimit, Fitim Maksutaj, dyshoheshin për përvetësim të fondeve të burgut dhe falsifikim të faturave. Ata u liruan me kusht që të mos u afroreshin dëshmitarëve të mundshëm të këtij rasti apo nëpunësve të zyrës për financa të Burgut të Dubravës, dhe të mos hynin në vendin e tyre të mëparshëm të punës. Hetimet u zhvilluan edhe kundër një ish-anëtari të stafit ndërkombëtar.

Gjykimi i Sanije Gashit, e cila akuzohej për përvetësim të \$70,000 (48,000 euro) gjatë mandatit të saj si menaxhere për buxhet dhe financa në Administratën Tatimore të Prishtinës, filloi gjatë korrikut dhe gushtit.

Asnjë ligj nuk parashikon qasje në dokumentet zyrtare të UNMIK-ut. Ligji parashikon qasje në dokumentet zyrtare të IPVQ-së, por nuk përfshin dënimet për dështim të zbatimit të tij; në praktikë, institucionet e IPVQ-së rrallë ofronin qasje gjatë këtij viti. Institucionet dështuan t'u përgjigjeshin pothuaj 85 për qind të kërkesave të paraqitura gjatë këtij viti (690 prej 820), sipas një studimi të Iniciativës rinore për të drejta të njeriut, dhe ata që u përgjigjën më së shpeshti refuzuan t'i siguronin dokumentet e kërkuara. Vetëm gjashtë prej 318 kërkesave të paraqitura në gjuhën serbe u përgjigjën në gjuhën serbe, siç kërkohet me ligj. Ndonëse shumica e përgjigjeve jepeshin brenda afatit prej 15 ditësh, gazetarët ankoreshin se afati prej 15 ditësh do të thoshte se ata kurrë nuk do të mund t'i merrnin dokumentet zyrtare me kohë për ta përmbushur afatin e tyre për botim.

Gjatë këtij viti, mediat rregullisht ankoreshin për mungesën e qasjes në dokumente zyrtare, edhe pse qasja e tillë parashikohej me ligj. Në fund të gushtit, Shoqata e gazetarëve profesionistë të Kosovës raportoi se një studim që vlerësonte përgjigjen e institucioneve qeveritare dhe publike ndaj kërkesave të mediave për dokumente zyrtare tregoi se vetëm 23 për qind e kërkesave ishin kompletuar me sukses. Studimi tregoi se asnjë institucion të cilit gazetarët iu drejtuan nuk i siguroi kërkuarët regjistrin e dokumenteve në dispozicion.

Seksioni 4 Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendëse dhe ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punoi pa kufizim, duke hetuar dhe botuar konkluzionet e veta mbi rastet e të drejtave të njeriut. UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi bashkëpunonin dhe u përgjigjeshin pikëpamjeve të tyre.

Institucioni i Ombudspersonit ishte përgjegjës për hetimin e pohimeve për abuzim të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e Qeverisë. Ndonëse zyra e ombudspersonit aktivisht lëshonte letra ndërhyrjeje, raporte dhe rekomandime, ato nuk zbatoheshin gjithmonë nga IPVQ-ja, gjykatat lokale apo SHPK-ja. Rastet e hetuara nga zyra kishin të bënin me të drejta pronësore, abuzim të autoritetit zyrtar, me akte administrative apo mangësi nga autoritetet publike, me

mungesë të hetimeve të mirëfillta për vepra penale, me çështje ku përfshihej kohëzgjatja e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, me konteste lidhur me punësimin, dhe me mosndëshkim. Më 2005, pas përfundimit të mandatit të ombudspersonit ndërkombëtar, ish-zëvendësi i ombudspersonit, Hilmi Jashari, vazhdoi të shërbente si ushtrues detyre i Institucionit të Ombudspersonit gjatë këtij viti. Më 2006, mandati i ombudspersonit u ndryshua për ta përjashtuar UNMIK-un nga fushëveprimi i vet; një panel i ri konsultativ për të drejta të njeriut në kuadër të UNMIK-ut u themelua në prill dhe u ngarkua për ta mbikëqyrur UNMIK-un.

UNMIK-u, KFOR-i dhe IPVQ-ja në përgjithësi bashkëpunuan me TPNJ-në. Më 2005, TPNJ akuzoi ish-kryeministrin Ramush Haradinaj dhe të bashkëpandehurit Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj për krime lufte të kryera më 1998. Gjykimi filloi në mars dhe ishte në vazhdim e sipër në fund të vitit.

Seksioni 5 Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Rregulloret e UNMIK-ut dhe të IPVQ-së posaçërisht ndalojnë diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, prejardhjes etnike, aftësisë së kufizuar, apo gjuhës; megjithatë, dhuna dhe diskriminimi ndaj femrave, personave me aftësi të kufizuara, dhe pakicave etnike vazhdoi.

Femrat

Rregulloret e UNMIK-ut e konsiderojnë dhunimin vepër penale; megjithatë, dhunimi bashkëshortor nuk u trajtua në mënyrë të posaçme. Sipas kodit të përkohshëm penal, dhunimi dënohet prej 1 – 10 vjet burg; dhunimi i të miturave (marrëdhënia seksuale me një vajzë nën moshën 14-vjeçare) dënohet prej 1 – 5 vjet burg.

Nuk u raportua në masë të madhe për dhunim për shkak të turpit kulturor që u bashkëngjitej viktimave dhe familjeve të tyre. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, avokatët e viktimave u ofruan shërbime viktimave në rreth 82 raste të dhunimit gjatë këtij viti. Policia e UNMIK-ut raportoi se SHPK-ja arrestoi gjashtë persona për dhunim gjatë këtij viti.

Dhuna në familje ndaj femrave, përfshirë këtu abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz dhe i vazhdueshëm. Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë dhunën në familje dhe parashohin dënime me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet. Kur viktimat ngrinin padi, njësitë e SHPK-së për dhunë në familje kryenin hetime dhe ua kalonin rastet prokurorëve. Sipas UNMIK-ut, besnikëritë familjare dhe bashkësitë e lidhura ngushtë dhe grumbullimi i rasteve në gjykatat civile dhe penale i shtuan shkallës së ulët të ndjekjes penale.

Si me dhunimin, dhuna në familje mbeti problem i madh për të cilin nuk u raportua aq shumë. Në korrik, OSBE-ja lëshoi një raport mbi dhunën në familje. Raporti theksonte problemet në gjykimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë këtu vonesat e paligjshme në shqyrtimin e kërkesave për urdhra për mbrojtje. OSBE-ja gjithashtu shprehu shqetësim lidhur me procedurat e apelimit në rastet e dhunës në familje; në disa raste, gjykatat në mënyrë të paligjshme shënonin në vendimet e tyre se ankesa nga i pandehuri e pezullonte ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.

SHPK-ja raportoi që 53 viktima të dhunës në familje ishin vendosur në strehimore gjatë këtij viti. Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve u ofroi ndihmë 43 viktimave të dhunës në familje dhe të dhunës seksuale prej janarit deri më 30 gusht. Njësia e Ministrisë së Drejtësisë për përkrahje dhe ndihmë për viktima u angazhua në 334 raste të dhunës në familje ndërmjet janarit dhe qershorit. Ndonëse dënimet në raste të tilla ishin të rralla, ato sillleshin prej qortimeve gjyqësore deri në dënime me burg. Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave në shoqërinë e dominuar nga meshkujt i kontribuan shkallës së lartë të abuzimit në familje dhe numrit të vogël të rasteve të raportuara.

Nuk kishte agjenci qeveritare që merreshin enkas me dhunën në familje. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale siguroi ndihmë financiare për OJQ-të që drejtonin strehimore për viktime të dhunës në familje, ku ishin të vendosura edhe disa viktime të trafikimit. Ministria siguroi shërbime sociale përmes Qendrave për Mirëqenie Sociale. Ministria e Drejtësisë drejtonte një strehimore për persona të trafikuar. Gjithsej gjashtë strehimore u ndihmonin viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit, përfshirë këtu një strehimore që drejtohej nga një OJQ ndërkombëtare. SHPK-ja raportoi se 66 viktime të dhunës në familje pranuan strehim gjatë këtij viti. Disa OJQ vendëse e ndërkombëtare zhvilluan aktivitete për t'u ndihmuar femrave; megjithatë, ato ishin të kufizuara nga tradita e heshtjes lidhur me dhunën në familje, abuzimin seksual dhe dhunimin.

Gjatë këtij viti, një linjë e drejtpërdrejtë anonime për raportimin e abuzimit në familje punonte 24-orë në ditë në Prishtinë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë. 70 për qind e thirrjeve ishin nga viktimat e dhunës në familje, ndërsa rastet e trafikimit të personave, të keqtrajtimit seksual dhe të abuzimit të fëmijëve përbënin pjesën tjetër. Linja e drejtpërdrejtë i informonte thirrësit për të drejtat e tyre, strehimet e mundshme dhe informata përkatëse.

Shkolla e SHPK-së për trajnim ofronte në programin e vet mësimor kurse të posaçme mbi dhunën në familje dhe dhunimin. Nuk pati raportime që SHPK-ja reagoi pa vend ndaj supozimeve për dhunim apo abuzim në familje.

Ligji ndalon prostitucionin, por ai mbeti i përhapur. Njësia hetuese e Policisë së UNMIK-ut për trafikim dhe prostitucion i hetonte rastet e prostitucionit.

Nuk kishte ligj të posaçëm kundër ngacmimit seksual, që ishte problem i rëndomtë. Vetëdijesimi shoqëror për ngacmim seksual mbeti i ulët, dhe pak raste u raportuan.

Femrat kanë të drejta të njëjta ligjore si meshkujt, por tradicionalisht kanë status më të ulët shoqëror, gjë që ndikoi në trajtimin e tyre brenda sistemit ligjor. Me gjithë mungesën e pengesave ligjore, relativisht pak femra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në tregti, SHPK, apo Qeveri. Ndonëse numri i femrave të punësuar vazhdoi të rritej, shkalla e papunësisë së femrave mbeti e lartë, rreth 70 për qind, 20 – 25 për qind më e lartë se shkalla e papunësisë për meshkuj. Femrat përbënin më pak se 34 për qind të fuqisë punëtore të qeverisë.

Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj femrave rezultuan në diskriminim. Në disa zona rurale, femrat shpesh kishin pak mundësi për të marrë vendime ku përfshiheshin fëmijët e tyre ose për të ushtruar kontroll mbi pronën. Ndonëse femrat dhe meshkujt kanë të drejta të barabarta ligjore për ta trashëguar pronën, prona e familjes zakonisht u kalohet vetëm meshkujve. Të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kalohen familjes së babait të vdekur, ndërsa e veja të kthehet në familjen e saj.

Fëmijët

UNMIK-u dhe IPVQ-ja në përgjithësi angazhoheshin për mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve.

Rregulloret e UNMIK-ut kërkojnë që fëmijët e moshës ndërmjet 6 dhe 15-vjeçare të regjistrohen në shkollim të obligueshëm. Shkollimi i obligueshëm, që përbehet prej nëntë klasave, është falas. Sipas statistikave të vitit 2005, 97.5 për qind e fëmijëve shqiptarë dhe 99 për qind e fëmijëve serbë ishin të regjistruar në shkollën fillore, ndërsa vetëm 77 për qind e fëmijëve të moshës ndërmjet 7 dhe 14-vjeçare nga bashkësitë pakicë jo-serbe (romë, ashkalinj, egjiptianë, turq, boshnjakë, goranë dhe të tjerë) vijonin shkollimin. 69 për qind e vajzave nga pakicat jo-serbe e vijonin shkollimin.

UNICEF-i raportoi që mungesa e objekteve për shkollimin e pakicave në disa pjesë të Kosovës e vështirësoi kthimin e PZHBV-ve në shtëpitë e veta.

UNICEF-i vlerësoi se më pak se 75 për qind e fëmijëve që e mbaronin shkollimin e obligueshëm fillor, regjistroheshin në shkollën e mesme, dhe më pak se 55 për qind e vajzave shqiptare regjistroheshin në shkollën e mesme. Vetëm rreth 40 për qind e vajzave nga bashkësitë pakicë joserbe regjistroheshin në shkollën e mesme.

Sipas UNICEF-it, rreth 40 për qind e popullatës ishte nën moshën 18-vjeçare, dhe 33 për qind e popullatës nën moshën 15-vjeçare. Më pak se 10 për qind e fëmijëve të moshës dy deri në pesë vjeç e vijonin arsimin parashkollor.

Rregulloret e UNMIK-ut kërkojnë kushte të barabarta për të gjithë nxënësit, dhe parashikojnë të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare, për nxënës të pakicave, deri në mbarim të shkollës së mesme. Shkollat që mësimin e zhvillonin në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke punuan gjatë këtij viti. Fëmijët serbë dhe shqiptarë e vijonin mësimin në shkolla me lehtësira joadekuate të cilave u mungonin pajisjet themelore. Nxënësit serbë dhe shqiptarë i ndiqnin mësimet në disa shkolla të njëjta, por me programe të ndryshme mësimore dhe në ndërrime.

Fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë i vijonin mësimet në shkolla të përziera me fëmijët shqiptarë, por thuhej se përballeshin me kërcënim në disa zona me shumicë shqiptare. Fëmijët romë ishin më të prapambetur për shkak të varfërisë, gjë që i shtyri shumë prej tyre të fillonin të punonin në shtëpi e në rrugë që në moshë të re për të kontribuar në të ardhurat e familjes. Fëmijët romë ishin gjithashtu më të prapambetur sepse u desh ta mësonin një gjuhë tjetër për ta vijuar shkollimin pasi shumica flisnin gjuhën romë në shtëpi. Disa fëmijë boshnjakë në zonat kryesisht boshnjake mund ta vijonin mësimin në gjuhën e tyre në shkollën fillore, por ata fëmijë që ishin jashtë zonave të tilla mësimin e vijonin në gjuhën shqipe.

Një studim i kryer nga UNICEF-i dhe Ministria e Arsimit lidhur me mbizotërimin e dhunës në shkolla zbuloi se dhuna kundër fëmijëve kalonte pa u ndëshkuar. Ndëshkimi trupor ishte praktikë e pranuar në shtëpi dhe shkolla. Fëmijët që jetonin larg nga shkolla raportonin se kishin frikë ta kalonin atë distancë për shkak të kërcënimit të shokëve me dhunë. Fëmijët raportonin se personat afër tyre ishin autorë të veprave të dhunës; se djemtë ishin më të rrezikuar nga dhuna fizike dhe vajzat ishin më të rrezikuara nga abuzimi verbal. Prej fëmijëve të moshës 6 – 11-vjeçare, 75 për qind e perceptonin rrugën si vendin më të dhunshëm, 27 për qind thanë se shkolla ishte skenë e ngjarjeve të dhunshme, dhe 12 për qind e përmendën shtëpinë. 37 për qind e fëmijëve më të moshuar mendonin se dhuna kundër fëmijëve në shkolla ishte fenomen i përhapur.

Fëmijët pa prind vendoseshin në vendbanime të ndryshme, përfshirë këtu kujdesin e zgjeruar familjar, kujdesin birësues, dhe në shtëpi të bashkësisë. Megjithatë, pasi programet vendore për adoptim dhe programet familjare për birësim nuk shkonin në hap me shkallën e braktisjes, autoritetet nganjëherë i vendosnin foshnjat dhe fëmijët në shtëpi grupore me pak kujdestarë. Fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh fshiheshin pa kujdes të duhur, posaçërisht në zonat rurale.

Gjatë këtij viti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale drejtonte 31 qendra për mirëqenie sociale që u ndihmuan 1,253 jetimëve dhe 913 fëmijëve delinkuentë. Ministria gjithashtu menaxhoi shtëpitë për fëmijë të braktisur dhe koordinoi punën me OJQ për t'i vendosur fëmijët në strehimore të përkohshme. Sipas Qendrës për punë sociale, 19 fëmijë të braktisur, me aftësi të kufizuara, të moshës prej 3 – 18-vjeç, jetonin në dy shtëpi të financuara nga qeveria nën kujdes 24-orësh.

U raportua për martesë të fëmijëve, posaçërisht ndër bashkësitë rome, ashkallike, egjiptiane dhe shqiptare. UNMIK-u nuk mblodhi të dhëna për këtë çështje, kështu që përmasa e këtij problemi ishte e paqartë.

Trafikimi i personave

Rregulloret e UNMIK-ut, kodi i përkohshëm penal dhe kodi i procedurës penale e konsiderojnë trafikimin e personave vepër penale; megjithatë, trafikimi i femrave dhe i fëmijëve mbeti problem serioz.

Kosova ishte burim, pikë transiti dhe destinacion për persona të trafikuar, dhe trafikimi i brendshëm ishte problem në rritje e sipër. Viktimat ishin femra dhe fëmijë të trafikuar brenda vendit apo nga Evropa lindore, Ballkani, dhe ish-Bashkimi Sovjetik në Kosovë, kryesisht për shfrytëzim seksual, por edhe për robëri shtëpiake apo për punë të detyruar në bare dhe restorante. Viktimat gjithashtu trafikoheshin përmes Kosovës për në Maqedoni, Shqipëri dhe në vende të Evropës perëndimore. Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), të tetë personat e identifikuar si viktima të jashtme të trafikimit gjatë këtij viti u kthyen vullnetarisht në vendin e tyre të prejardhjes.

Sipas SHPK-së dhe IOM-it, trafikimi i personave ishte problem në rritje e sipër. Shënimet e IOM-it tregonin se afërsisht 73 për qind e viktimave të trafikimit ishin kosovare, pasonin femrat nga Moldavia (13 për qind), Shqipëria (10 për qind), dhe Ukraina (3 për qind). Të dhënat e SHPK-së dallonin. Ato tregonin se 56 për qind e viktimave ishin trafikuar brenda vendit, 28 për qind nga Shqipëria, 9 për qind nga Moldavia dhe 3 për qind nga Maqedonia e Serbia. SHPK-ja gjithashtu raportoi për vështirësi të mëdha në identifikimin e viktimave të trafikimit për shkak të ngurrimit të tyre për t'u paraqitur në polici për ta raportuar krimin. Tabutë kulturore dhe kërcënimi nga diskriminimi shoqëror bënë që shumica e viktimave të trafikuar brenda vendit të heshtnin për përvojat e tyre. Një vështirësi tjetër ishte pamundësia e SHPK-së për të rekrutuar policë serbë të Kosovës për njësinë kundër trafikimit, dhe kjo e pengonte zhvillimin e operacioneve të fshehta në Kosovën veriore dhe në enklavat e serbëve të Kosovës.

Viktimat e trafikimit shfrytëzoheshin kryesisht në industri të seksit, më së shumti në shtëpi publike dhe klube të natës, por me të madhe edhe në banesa private dhe përmes shërbimeve të prostitucionit. Asnjëra prej tyre nuk raportoi se e dinte që do të punonte në industri të seksit kur i lëshonin shtëpitë e tyre. Viktimat e trafikimit raportuan se rregullisht u nënshtroheshin rrahjeve dhe dhunimit, u mohojë qasja në kujdes shëndetësor, dhe u konfiskoheshin dokumentet e udhëtimit e të identifikimit. Viktimat shpesh gjendeshin në kushte të mjera fizike e psikologjike.

UNMIK-u raportoi se trafikantët shpesh punonin si pjesë e një përpjekjeje të koordinuar ndërmjet elementeve serbe dhe shqiptare të krimit të organizuar, dhe disa femra trafikoheshin prej ose përmes Serbisë për në Kosovë. Pronarët e bareve dhe të shtëpive publike i blinin viktimat nga bandat e krimit të organizuar.

Metodat e trafikimit u bënë më të sofistikuara. Si reagim ndaj një fushate agresive të autoriteteve lokale e ndërkombëtare për çrënjosjen e trafikimit, trafikantët e transferuan tregtinë e seksit komercial prej bareve e klubeve publike në shtëpi private, ku ishte më vështirë të zbuloheshin këto operacione. Trafikantët me të madhe e përdornin stimulimin financiar për t'i inkurajuar viktimat që ta refuzonin ndihmën.

IOM-i raportoi se prej 569 viktimave kryesisht ndërkombëtare që u kishte ndihmuar që nga viti 1999, 74 për qind u bënë viktima të trafikantëve pas pranimit të ofertës së rreme për punë jashtë vendit, 4 për qind pohuan se ishin kidnapuar, 4 për qind pohuan se u ishte premtuar martesë. Në 83 për qind të rasteve, rekrutimi bëhej përmes kontakteve të rëndomta personale; rekrutuesi ishte i

njohur i viktimës në 29 për qind të rasteve dhe shok apo mik i familjes në rreth 16 për qind të rasteve. Rekrutuesit ishin më së shpeshti femra.

Sipas Kodit të përkohshëm penal, trafikimi është krim që dënohet deri në 20 vjet burg. Angazhimi në trafikim dënohet prej 2 deri në 12 vjet burg, ose deri në 15 vjet nëse viktimja është e mitur; organizimi i një grupi për t'u marrë me trafikim dënohet prej 7 deri në 20 vjet burg dhe me gjobë deri në \$730,000 (500,000 euro); lehtësimi i trafikimit nëpërmjet neglizhencës dënohet prej 6 muaj deri në 5 vjet burg. Klienti që fajësohet për marrëdhënie seksuale me një person për të cilën dihet se është viktimë e trafikimit mund të dënohet me burg prej tre muaj deri në 5 vjet, ndërsa marrëdhënia seksuale me një të mitur për të cilën dihet se është viktimë e trafikimit mund të dënohet prej dy deri në 10 vjet burg. Lehtësimi i prostitucionit dënohet me gjobë apo me burg deri në tri vjet, dhe deri në pesë vjet nëse ndodh brenda perimetrit prej 350 metrash nga shkolla apo ndonjë lokacion tjetër që shfrytëzohet nga fëmijët. Kur kundërvajtja për prostitucion përfshin viktimat që janë të mitura, dënimi me burg mund të jetë deri në 12 vjet. Prostitucioni dënohet si kundërvajtje; prostitutat mund të dënohen, por jo edhe klientët, nëse policia nuk mund të dëshmojë që klienti me qëllim i ka shfrytëzuar shërbimet e viktimës së trafikimit. Prostitucioni përbën bazë për dëbim, përveç nëse "prostituata" është viktimë e trafikimit.

Në maj 2006, UNMIK-u ia barti SHPK-së përgjegjësitë për aktivitetet kundër trafikimit; gjatë këtij viti, SHPK-ja mbajti përgjegjësinë kryesore për luftimin e trafikimit të personave dhe kreu 120 operacione të vëzhgimit. SHPK-ja gjithashtu mbylli 45 ndërmarrje afariste që përdorshin për trafikim. Gjatë këtij viti, SHPK-ja arrestoi 43 persona për trafikim, një për kodoshllëk, një për prostitucion, dhe 8 për akuza të lidhura me trafikimin, si posedimi ilegal i armëve dhe falsifikimi. SHPK-ja gjithashtu identifikoi 41 viktimat të trafikimit, 28 prej të cilave morën ndihmën e nevojshme, përfshirë këtu akomodimin e sigurt, këshillimin dhe trajnimin profesional për kthim dhe riintegrim në shoqëri. Së paku një strehimore ofronte kujdes shëndetësor në përputhje me marrëveshjet e veta me ofruesit e kujdesit shëndetësor. Zyra e prokurorit ngriti 33 raste për trafikim të personave; 28 raste të tjera nga viti i kaluar mbetën të hapura. 13 raste u përfunduan, duke rezultuar në 13 dënime.

Faktorët që i kontribuuan numrit të ulët të ndjekjeve penale përfshinin përsosjen gjithnjë e më të madhe të përpjekjeve të krimit të organizuar për t'iu shmangur lidhjeve të drejtpërdrejta ndërmjet viktimave dhe personaliteteve të larta të krimit, mungesën e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve (ndonëse përdorshin mjetet për të siguruar anonimitet gjatë dëshmisë në gjykim), ngurrimin e viktimave për të bashkëpunuar me autoritete, trajnimin joadekuat të personelit gjyqësor, dhe dështimin e policisë për t'iu përshtatur teknikave të reja që përdorshin nga trafikantët

Rregulloret e UNMIK-ut parashikojnë mbrojtje për viktimat të trafikimit ndaj akuzave penale për prostitucion, hyrje ilegale, prani, apo punë në Kosovë. Në të kaluarën, gjykatësit vendës nganjëherë padrejtësisht i dënonin viktimat e trafikimit me burg ose padrejtësisht lëshonin urdhra për dëbimin e femrave të dënuara për prostitucion ose për mungesë të dokumenteve. Ndryshe nga vitet e mëparshme, gjatë këtij viti nuk pati raportime që praktika të tilla ndodhën.

IOM-i dhe SHPK-ja raportojnë që personat e trafikuar shpesh kishin kontrata pune që u mundësonin të hynin legalisht në Kosovë dhe të fitonin leje qëndrimi. Kjo e vështirësonte zbulimin dhe vërtetimin e trafikimit të personave.

SHPK-ja ndante përgjegjësinë për luftimin e trafikimit me UNMIK-un, policinë kufitare, OSBE-në, Zyrën për qeverisje të mirë, prokurorët, gjykatësit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, posaçërisht IOM-i, merreshin me aktivitete për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit. IPVQ-ja, në bashkëpunim me OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe

qeveritë e huaja, vazhdoi ta zbatonte Planin e Kosovës 2005 për veprim për ta luftuar trafikimin e personave. Aktivitetet përfshinin intervista në media me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit për këtë problem, një garë për raportimin më të mirë mbi trafikimin, xhirimin e filmit kundër trafikimit *Rekrutimi*, premiera e të cilit u shfaq në Prishtinë dhe më vonë u transmetua në TV në tërë Kosovën. Megjithatë, vlerësimi i planit për veprim të projektit të partneritetit kundër trafikimit të personave, të botuar në shtator, zbuloi se vetëm katër prej aktiviteteve të tij të planifikuara ishin jetësuar deri në fund të qershorit dhe 20 aktivitete të tjera duhej të fillonin. Aktivitetet e tjera ishin në vazhdim. Plani skadoi në dhjetor, dhe IPVQ-ja nuk e vazhdoi atë.

IOM-i u ndihmoi 31 viktimave të trafikimit gjatë këtij viti, 23 prej tyre ishin nga Kosova. Më tepër se gjysma e viktimave nga Kosova ishin të mitura (12 raste), dhe të gjitha, përveç njëjës (që ishte trafikuar për në Mal të Zi) ishin trafikuar brenda vendit. Si më 2006, IOM-i u kishte ndihmuar më tepër viktimave vendëse sesa viktimave të huaja të trafikimit. Prej viktimave të huaja që IOM-i u kishte ndihmuar që nga viti 1999, mbi 51 për qind ishin nga Moldavia, 19.5 për qind nga Rumania, 13 për qind nga Ukraina, dhe të tjerat ishin nga Bullgaria, Shqipëria, Rusia, Serbia, Mali i Zi, Sllovakia dhe Nigeria. Shumica e këtyre viktimave ishin të moshës ndërmjet 18 – 25-vjeçare. Shifrat e IOM-it tregonin se 82 për qind e viktimave kosovare trafikoheshin brenda vendit, ndërsa rreth 8 për qind trafikoheshin për në Maqedoni, dhe 4.5 për qind për në Shqipëri dhe Itali.

Numri i përgjithshëm i rasteve të trafikimit ku përfshiheshin të miturat u ngrit që nga viti 2006. Ndonëse një prej viktimave të huaja të trafikimit që IOM-i u ndihmoi gjatë këtij viti ishte e mitur, rreth 55 për qind e viktimave vendëse ishin të mitura. Fëmijët dhe vajzat e reja nga zonat rurale përbënin mbi 50 për qind të viktimave të trafikimit. Fëmijët dhe vajzat e reja nga familjet me shkallë të lartë të varfërisë, papunësisë, abuzimit në familje, dhe analfabetizmit ishin posaçërisht në rrezik për t'u trafikuar. IOM-i raportoi se 10 për qind e viktimave vendëse nuk ishin të regjistruara në shkollë; 35 për qind e kishin mbaruar vetëm klasën e pestë të shkollës fillore; 45 për qind e kishin mbaruar klasën e nëntë të shkollës fillore; 8 për qind e kishin mbaruar shkollën e mesme; dhe më pak se një për qind i ndiqnin studimet në universitet.

Pati dëshmi anekdotike gjatë këtij viti se ekzistonte një grup i ndërlikuar i marrëdhënieve financiare dhe i lidhjeve familjare ndërmjet udhëheqësve politikë dhe rrjeteve të krimit të organizuar që kishin interesa financiare nga trafikimi.

Policia arrestoi disa persona dhe ndërmori masa kundër trafikantëve gjatë këtij viti. Në janar, p.sh., SHPK-ja arrestoi dy shqiptarë të Kosovës që drejtonin kafenetë Suka dhe Suka 1 në Prizren, pas marrjes së informatave për një viktimitë shqiptare të Kosovës e cila ishte punësuar si pastruese dhe më pas ishte detyruar të merrej me prostitucion. SHPK-ja intervistoi gruan dhe konstatoi se ishte në gjendje të traumatizuar; e dërgoi në spitalin e Prizrenit, ku mjekët konstatuan se trafikantët nuk i kishin dhënë ushqim e ujë, por vetëm alkool. Mjekët i dhanë infuzion dhe më pas e liruan për të shkruar në strehimore. Suka dhe Suka 1 u mbyllën.

Në mars, pesë shqiptarë të Kosovës u arrestuan për trafikim të femrave në një shtëpi private në Gjilan, dhe një viktimitë 45-vjeçare u shpëtua. Njëri prej trafikantëve, një burrë 74-vjeçar, vdiq në burg. Personi i gjashtë kërkohet në lidhje me rrjetin e trafikimit, por mbeti në liri.

Më 22 qershor, SHPK-ja kreu një operacion të fshehtë në një kafene në Fushë Kosovë, që rezultoi në arrestimin e një shqiptari dhe në shpëtimin e dy femrave shqiptare. Trafikanti i dyshuar u dërgua në burg për 30 ditë, por prokurori më vonë konkludoi se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për ta ndjekur atë penalisht për trafikim.

OJQ-të ndërkombëtare dhe vendëse, të financuara nga donatorë të huaj, ishin burimi kryesor i ndihmës për viktimat e trafikimit. OJQ-të vendëse, si Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe

parandalimin e trafikimit dhe Qendra për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve, në bashkëpunim me UNMIK-un, OSBE-në dhe IOM-in, drejtonin strehimore ku viktimave të trafikimit u ofrohej kujdes mjekësor dhe shërbime të këshillimit psikologjik. OJQ-ja Shpresë dhe shtëpi për fëmijë drejtonte një strehimore për fëmijë që ishin viktimat të trafikimit, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe OSBE-në, drejtoi një njësi strehimi grupor, gjysmë të pavarur, për të miturit që ishin viktimat të trafikimit dhe të dhunës në familje. Disa strehimore vendëse për viktimat të dhunës në familje, si Liria në Gjilan, ofronin strehim afatshkurtër dhe shërbime referimi për viktimat të rrezikut të sigurisë së ulët. Një objekt i përkohshëm i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë u ofronte strehim të përkohshëm viktimave gjersa ato mendonin të riatdhesoheshin apo të dëshmonin kundër trafikantëve. Policia shpesh ia drejtonte IOM-it viktimat e dyshuara të trafikimit nëpërmjet zyrtarëve rajonalë të OSBE-së.

Personat me aftësi të kufizuara

Disa rregullore të UNMIK-ut e ndalojnë diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në punësim, shkollim, qasje në kujdes shëndetësor, dhe në ofrim të shërbimeve të tjera shtetërore; megjithatë, pati diskriminim të madh në praktikë, dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara nuk ishin prioritet i IPVQ-së. Sipas OJQ-së vendëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, HandiKos, ligjet që kishin të bënin me personat me aftësi të kufizuara nuk zbatoheshin në mënyrë adekuate. Si rrjedhojë, fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh përjashtoheshin nga mundësitë edukative, nuk vlerësoheshin në mënyrë profesionale, dhe u mungonin shërbime të mjaftueshme shëndetësore dhe sociale. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në Kosovë ishin 14,000-15,000 fëmijë me aftësi të kufizuara. Ekzistonin shtatë shkolla speciale për fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe 50 klasë për fëmijë me nevoja të posaçme që u ishin shtuar shkollave të rregullta. Ministria raportoi se kishte mbi 900 nxënës që pranonin shkollim special, dhe llogaritej që 2.5 për qind e nxënësve në shkolla të rregullta kishin aftësi të kufizuara. Ndërmjet 84 dhe 90 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk kishin qasje në shkollim; të tjerët ishin vendosur në shkolla speciale të veçuara.

Nuk pati mbrojtje të posaçme ligjore për fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe Këshilli për Ekonomi dhe Financa pohoi se nuk kishte mjete të mjaftueshme për të mbështetur programe të tilla. Nuk kishte ligj që e definonte statusin e personave me aftësi të kufizuara, e as dispozita për trajnimin apo punësimin e tyre. Nuk kishte ligje mbi kujdestarinë me mbrojtje përkatëse me proces të duhur, dhe rregulloret nuk e njihnin vendosjen e individëve me aftësi të kufizuara mentale në institucione si çështje të ndarë ligjore nga çështja e trajtimit kundër dëshirës. Ligji lejon qasjen në ndërtesa zyrtare; megjithatë, ai nuk hyri në fuqi dhe rrallë zbatohet në praktikë.

Sipas OJQ-së Mental Disability Rights International (MDRI), pacientët me aftësi të kufizuara mentale vazhdonin të mbaheshin të izoluar pa kurrfarë baze ligjore, pasi nuk ka ligj për ta rregulluar procesin e dërgimit të personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose social, apo për t'i mbrojtur të drejtat e tyre brenda institucioneve. Herë pas here, individët që kishin nevojë për trajtim në shëndet mental dënoheshin për krime të inskenuara ose të vogla dhe dërgoheshin në burgje të cilave u mungonin burimet për trajtim adekuat. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), kishte rreth 14,000 persona me aftësi të kufizuar mentale; MDRI raportoi se rreth 50,000 persona me aftësi të kufizuar mentale jetonin jashtë institucioneve. Sipas MDRI-së, personat e tillë çonin jetë të izoluar dhe të stigmatizuar.

Në prill 2006, kryeministri themeloi Këshillin Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara si një organizatë këshillimore për autoritetet qeveritare dhe Kuvendin e Kosovës. Në maj, këshilli përcaktoi prioritetet e veta, kryesori ndër to ishte hartimi i një platforme kombëtare për persona me aftësi të kufizuara.

Nga fundi i vitit, as UNMIK-u, as IPVQ-ja nuk kishin ngritur padi penale apo ndërmarrë masa të tjera ligjore si përgjigje ndaj një raporti të MDRI-së të vitit 2002, që zbuloi dëshmi të gjera të abuzimit fizik, sulmit seksual, mospërfilljes, dhe ndalimit arbitrar nga personeli dhe pacientët në objektet e kujdesit të shëndetit mental në Institutin e Shtimes, në Shtëpinë e pleqve në Prishtinë dhe në Spitalin e Universitetit të Prishtinës. MDRI raportoi se, që nga shtatori 2006, Instituti i Shtimes ishte ndarë në një objekt për persona me paaftësi zhvillimore, me 74 pacientë, dhe në një objekt psikiatrik me 68 pacientë. Shumica e pacientëve në Shtime ishin serbë dhe pakica të tjera. MDRI gjithashtu raportoi se pacientët e ri pranoheshin në këtë objekt përkundër një politike të vitit 2001 për “mospranim”.

Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale, dhe Ministria e Shërbimeve Publike ishin përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Një raport i MDRI-së, më 2004, theksoi se kujdesi institucional ndaj personave me aftësi të kufizuara mentale i la ata të izoluar, arbitrarisht të ndaluar, dhe të cenusur ndaj dhunës fizike dhe abuzimit seksual. Më 2005, IPVQ-ja i zgjeroi opsionet për jetesë të pavarur për persona të tillë dhe shpenzoi \$175,000 deri në \$292,000 (120,000 – 200,000 euro) në secilën prej 14 shtëpive për integrim të miratuara nga MDRI-ja. MDRI raportoi se, ndonëse këto shtëpi ishin menduar të ishin të përkohshme, shumica e pacientëve kaluan vite të tëra në to me pak gjasa për t'u kthyer në bashkësi. Sipas një raporti të OBSH-së të vitit 2006, nuk kishte objekte të mjaftueshme për të siguruar kujdes për personat me aftësi të kufizuara mentale, dhe mundësitë për punësimin e personave me aftësi të kufizuara mentale ishin të kufizuara. KMDLNJ raportoi se të burgosurit me aftësi të kufizuara mentale shpesh mbaheshin në burgje për shkak të mungesës për të siguruar trajtim për shëndet mental.

Pakicat kombëtare/raciale/etnike

Diskriminimi zyrtar dhe shoqëror kundër bashkësisë serbe, rome, ashkallike dhe egjiptiane sa i përket punësimit, shërbimeve sociale, përdorimit të gjuhës, lirisë së lëvizjes, të drejtës për t'u kthyer, dhe të drejtave të tjera themelore vazhdoi, ndonëse raportet për diskriminim të tillë shënuan rënie në krahasim me vitin 2006. Anëtarët e bashkësisë boshnjake dhe gorane gjithashtu u ankuan për diskriminim. Gjatë këtij viti, dhuna dhe krime të tjera të drejtuara kundër pakicave dhe pronës së tyre u pakësuan, por mbetën problem. Punësimi i pakicave në IPVQ vazhdoi të ishte i ulët dhe në përgjithësi kufizohej në nivele më të ulëta të qeverisë; anëtarët e pakicave zinin 10.4 për qind të vendeve të punës në qeveri, përkundër synimit të IPVQ-së prej mbi 16 për qind.

Më 20 korrik, ombudspersoni për të drejta të njeriut lëshoi një raport që konkludoi se diskriminimi etnik ishte problem i përhapur dhe i vazhdueshëm, posaçërisht në fushën e kujdesit shëndetësor dhe të punësimit. Raporti gjithashtu vuri në pah se grupet e pakicave vazhdonin të përballeshin me kërcënime të rregullta.

Që nga shtatori, policia e UNMIK-ut raportoi 457 raste të krimit ndëretnik; serbët ishin të përfshirë si viktimë apo të dyshuar në 342 raste. Sipas UNMIK-ut, incidentet që synonin pakicat në përgjithësi raportoheshin më pak për shkak të mosbesimit në SHPK dhe në sistemin ligjor, që rezultoi nga shkalla e ulët e hetimeve të suksesshme, e ndjekjeve penale dhe e dënimeve.

Pati raportime të shumta për dhunë kundër serbëve të Kosovës gjatë këtij viti, që zakonisht hetohej nga njësi e policisë ndërkombëtare, një njësi e përbërë nga policë ndërkombëtarë të OKB-së në kuadër të SHPK-së që i raporton drejtpërdrejt komisarit të policisë, i cili gjithashtu është anëtar i stafit ndërkombëtar.

Më 2 shkurt, një serbe e Kosovës u gjet prapa një kafeneje në Mitrovicë, e plagosur me thikë në bark. Policia mori në pyetje në shqiptar dhe dy boshnjakë. Hetimet e policisë vazhduan deri në fund të vitit.

Më 12 qershor, një adoleshent shqiptar sulmoi një serbe të moshuar në hyrje të banesës së saj në Prishtinë. Adoleshenti u arrestua dhe u dënua për këtë sulm; ankesa e tij u refuzua, dhe dënimi i tij prej tetë muaj burg u përkrah.

Më 4 shtator, një serbe e moshuar, Vucica Mikiq, u sulmua nga tre adoleshentë shqiptarë që gjuanin gurë në shtëpinë e saj në Klinë. Fqinji i saj e njoftoi policinë për këtë incident; Mikiq nuk pranoi të ngrite akuzë, por kërkoi patrulla shtesë policore në rajon.

Pati zhvillime në rastet e raportuara më parë të sulmeve kundër serbëve të Kosovës.

Më 25 qershor, kryetari i trupit gjykues për të mitur urdhëroi vlerësimin psikologjik të 16-vjeçarit "AD", shqiptar i Kosovës, për të cilin thuhej se kishte hedhur një mjet shpërthyes në hyrje të një kafeneje në Mitrovicën veriore në gusht 2006, me ç'rast 7 serbë të Kosovës, një boshnjak dhe një britanik ishin lënduar. AD u arrestua, akuzua dhe u lirua përkohësisht për shkak të gjendjes shëndetësore. Prokurori ndërkombëtar ngriti padi për këtë rast në dhjetor 2006, dhe AD mbeti në arrest shtëpiak deri në gjykim. Seancat e mëtejshme u pezulluan në pritje të rezultatit të vlerësimit psikiatrik. Më 4 dhjetor, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë konkludoi se AD vuan nga një çrregullim i përhershëm mendor dhe ishte i paaftë ta përballonte gjykimin. Prandaj ai u lirua nga akuzat.

Më 7 qershor, një gjykatës ndërkombëtar filloi shqyrtimin e aktakuzës së Sabri Hazirit, që akuzohej të kishte ndihmuar në vendosjen e një bombe në urën e hekurudhës që lidh zonat me shumicë shqiptare dhe serbe në prill 2003 afër fshatit Llozishtë në Zveçan.

Gjatë këtij viti nuk pati zhvillime në këto raste të vitit 2006: goditja me thikë, në mars, e një serbi të ri të Kosovës nga dy të rinj shqiptarë afër urës kryesore në Mitrovicën veriore; rasti i qershorit, në të cilin persona të panjohur shtinë me armë zjarri në drejtim të shtëpive të serbëve të kthyer në fshatin Llugë në Istog; dhe eksplozimi në dhjetor në linjën hekurudhore që shpesh përdorej nga anëtarët e pakicës serbe në komunën e Vushtrisë.

Nuk pati zhvillime në këto raste të vitit 2005: sulmi me bombë ndaj veturës zyrtare të udhëheqësit të serbëve të Kosovës, Olliver Ivanoviq; hedhja e granatës së dorës në zyrat në Zubin Potok të Partisë Demokratike Serbe për Kosovë e Metohi të Sllavisha Petkoviqit; dhe shtënia me armë kundër katër të rinjve serbë të Kosovës (dy prej të cilëve vdiqën më vonë) që ishin duke vozitur në Shtërpce.

Gjatë këtij viti pati raportime të rregullta që shqiptarët e Kosovës e shkatërruan pronën private që u takonte serbëve të Kosovës; disa raste të dhunës kundër serbëve mund të kenë qenë përpjekje për t'i detyruar që ta shitnin pronën e tyre. Një rregullore e UNMIK-u ndalon shitjen me shumicë të pronës së bashkësive të serbëve të Kosovës në përpjekje për ta penguar kërcënimin e pronarëve të pronave të pakicave në zona të caktuara; megjithatë, ajo rrallë zbatohet. Pati raportime që serbët e Kosovës kishin vështirësi për t'iu qasur pronës së tyre, që nganjëherë ishte e zënë ose shfrytëzohej nga shqiptarët e Kosovës. P.sh., disa serbë që kishin vendime në favor të tyre nga Agjencia Kosovare e Pronës nuk ishin në gjendje të kishin qasje në pronën e tyre në Klinë pa ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare dhe të presionit politik nga politikanët e lartë të IPVQ-së.

Në disa raste, u raportua që prona e serbëve të Kosovës shitej nga personat që rrejshëm pretendonin të ishin avokatë të tyre dhe paraqitnin dokumente të falsifikuara në gjykatë; në rastet në të cilat pronarët e ligjshëm nuk jetonin në Kosovë, mashtrimi i tillë nuk zbulohet me muaj të tërë.

Komunat veriore të Zveçanit, Mitrovicës, Zubin Potokut dhe Leposaviqit unanimisht vendosën t'i ndërprinin marrëdhëniet e tyre me IPVQ-në në qershor 2006, duke pohuar se kjo ishte si përgjigje ndaj disa krimeve të pazgjidhura kundër serbëve të Kosovës. Përkundër dëshmime pasuese, arrestimeve dhe deklaratave të qarta nga zyrtarët e UNMIK-ut dhe të SHPK-së se këto krime nuk ishin me motive etnike, këto tri komuna veriore nuk i kishin rifilluar marrëdhëniet me IPVQ-në deri në fund të vitit.

Pati raportime të shumta për incidente të hedhjes së gurëve ndaj automjeteve që bartnin serbë të Kosovës. UNMIK-u ia kaloi SHPK-së përgjegjësinë për përcjelljen e automjeteve të serbëve.

Pati zhvillime të reja në rastet e disa personave të ndaluar nën dyshimin se i kishin organizuar apo udhëhequr trazirat e vitit 2004. Më 20 shkurt, një prokuror ndërkombëtar ngrii aktakuzë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër pesë shqiptarëve të Kosovës për rolin e tyre në gjoja djegien e disa objekteve në Fushë Kosovë: Skender Islami, Mustafa Islami, Ramadan Islami, Omer Sylejmani, dhe Gazmend Morina. Të pandehurit u akuzuan për djegie të spitalit, të shkollës dhe të disa shtëpive dhe veturave serbe. Më 5 korrik, një gjykatës ndërkombëtar konfirmoi aktakuzën kundër Skender Islamit, Mustafa Islamit, dhe Ramadan Islamit, që mbetën në paraburgim. Procedurat kundër dy të pandehurve të tjerë u shtynë, duke pritur konfirmimin për moshën e tyre në kohën kur krimi ishte kryer.

Më 15 qershor, një trup i përzier gjykues i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i përbërë nga dy gjykatës ndërkombëtarë dhe një vendës, dënoi Esmine Hamzën dhe një të pandehur të mitur për një akuzë për nxitje të urrejtjes kombëtare, racore, fetare apo etnike, grindje dhe jotolerancë, për dy akuza për shkaktrim të rrezikut të përgjithshëm që rezultoi në humbje të madhe të pronës, dhe për një akuzë për pjesëmarrje në turmë që kreu vepër penale. Hamza u dënua me katër vjet burg, ndërsa i pandehuri i mitur u dërgua në një shtëpi edukative-korrektuese për dy vjet. Më 14 shkurt, një dëshmitare e këtij rasti dëshmoi se në mars 2004 shtëpia e saj ishte sulmuar dhe më vonë ishte djegur, dëmet llogariteshin rreth \$248,000 (170,000 euro). Një i afërm i dëshmitares, që refuzoi ta lëshonte shtëpinë, u rrah.

Në dhjetor 2006, policia arrestoi Zlyhaje Avdullahun për krime të kryera në mars 2004 në Fushë Kosovë. Thuhej që Avdullahu ishte pjesë e një turme të shqiptarëve të Kosovës që theu, plaçkiti dhe dogji shtëpitë e serbëve të Kosovës, dhe sulmoi serbët e Kosovës. Më 14 gusht, një gjykatës ndërkombëtar i procedurës paraprake urdhëroi masa alternative të paraburgimit ndaj Avdullahut për një muaj, që mbaruan më 14 shtator. Në fund të vitit, rasti pritej të gjykohej.

Më 21 gusht, një gjykim lidhur me trazirat e marsit 2004 filloi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë para një trupi gjykues të përbërë nga tre gjykatës ndërkombëtarë. Të pandehurit Mirsad Kurteshi dhe Kadri Sylejmani thanë se nuk ndiheshin fajtorë për akuzat që dilnin nga udhëheqja e tyre e supozuar e një grupi të madh të protestuesve në komunën e Obiliqit më 2004.

Pati raportime për dhunë me motive politike kundër pakicave jo-serbe gjatë këtij viti.

Më 8 janar, dy shqiptarë të Kosovës e sulmuan një egjiptian të Kosovës në Pejë; viktima u hospitalizua me lëndime të rënda. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Më 15 maj, një boshnjak i Kosovës raportoi se ishte sulmuar nga një shqiptar i Kosovës në Prizren. Ai u hospitalizua me lëndime të rënda, dhe policia arrestoi të dyshuarin. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Nuk pati zhvillime të reja në këto raste të vitit 2006: sulmi në gusht kundër malaziasit të zhvendosur Vuko Danilloviq, nga një grup i shqiptarëve të Kosovës; dhe sulmi me bombë, në tetor, në shtëpinë e një gorani, përfaqësues i Qendrës koordinuese të Beogradit për Kosovë e Metohi. SHPK-ja vazhdoi hetimet deri në fund të vitit.

Romët vuanin nga diskriminimi i përhapur shoqëror dhe ekonomik; shpesh u mungonte higjiena themelore, kujdesi mjekësor, dhe shkollimi; dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë. Ndonëse pati disa përpjekje të suksesshme për rivendosjen e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në shtëpitë që i kishin para konfliktit të vitit 1999 në Vushtrri, brengat e sigurisë vazhduan.

Udhëheqësit boshnjakë u ankuan se mijëra anëtarë të bashkësisë së tyre ishin larguar nga Kosova për shkak të diskriminimit dhe mungesës së mundësive ekonomike.

Më 21 maj, qeveria njoftoi për formimin e komisionit për përdorimin e gjuhëve, të përbërë nga përfaqësues të ministrive të qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës, për ta mbikëqyrur zbatimin e ligjit mbi gjuhët, i cili e bën gjuhën serbe gjuhë të dytë zyrtare në Kosovë dhe cakton kuotën prej 5 për qind për ta bërë gjuhën e folur nga një pakicë etnike gjuhë zyrtare në atë komunë. Ligji parashikon që turqishtja do të vazhdojë të jetë gjuha e tretë zyrtare në Prizren, pavarësisht nga përqindja e popullatës turke në komunë.

Abuzimet e tjera shoqërore dhe diskriminimi

Ligji ndalon diskriminimin e bazuar në orientim seksual; megjithatë, pati raportime për dhunë dhe diskriminim të drejtuar kundër homoseksualëve dhe lezbikeve.

Qëndrimet tradicionale shoqërore ndaj homoseksualizmit i frikësonin shumicën e homoseksualëve dhe lezbikeve, kështu që ata e fshihnin orientimin e tyre seksual. Homoseksualët dhe lezbiket në përgjithësi ndjeheshin të pasigurt, shumë prej tyre raportonin kërcënime për sigurinë e tyre personale. Mediat e shkruara nganjëherë i forconin këto qëndrime duke botuar artikuj negativë për homoseksualizmin, në të cilët homoseksualët dhe lezbiket i përshkruanin si të sëmurë mentalë dhe të prirë për t'i sulmuar fëmijët seksualisht. Disa homoseksualë gjithashtu raportuan për diskriminim në punë. Së paku një parti politike me orientim islam, Partia e Drejtësisë, përfshiu në platformën e vet politike dënimin e homoseksualizmit.

Më 18 maj, pas kremtimit të Ditës ndërkombëtare kundër homofobisë jashtë Prishtinës, katër meshkuj, tre të veshur në fustane, ishin duke u kthyer në shtëpi kur u ndalën nga policia dhe u detyruan të dilnin nga vetura. Policia i dërgoi në një stacion të afërt policor, ku, pasi i detyruan t'i përpinin dokumentet e identifikimit, i diskriminuan dhe poshtëruan. SHPK-ja nuk hapi dosje për këtë rast, dhe viktimat refuzuan të jepnin deklaratë për shkak të frikës nga diskriminimi i mëtejshëm.

Qendra për emancipim social, një OJQ vendëse që i përkrah të drejtat e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, dhe të transgjinitive, theksoi se pati shumë raste të tjera të diskriminimit kundër homoseksualëve gjatë këtij viti, por viktimat refuzonin që rastet e tyre të paraqiteshin publikisht për shkak të frikës nga diskriminimi.

Nuk pati zhvillime të reja në rastin e sulmit në mars 2006, në të cilin persona të panjohur rrahën brutalisht dy meshkuj të cilët i panë duke bërë seks. Njëri prej tyre vdiq më vonë nga lëndimet e marra.

Nuk pati raportime për diskriminim të personave me HIV/AIDS.

Seksioni 6 Të drejtat e punëtorëve

a. E drejta e asociimit

Rregulloret e UNMIK-ut u lejojnë punëtorëve të formojnë dhe t'u bashkëngjiten sindikatave që ata i zgjedhin, pa autorizim paraprak ose kërkesa të tepërta, por kjo e drejtë pengohet nganjëherë.

Sindikatat e vetme të rëndësishme ishin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), dhe Konfederata e Sindikatave të Lira (KSL). Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë diskriminimin antisindikal; megjithatë, disa zyrtarë të sindikatave raportuan për diskriminim në praktikë. BSPK raportoi se vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve e respektonte rregulloren që ndalonte diskriminimin antisindikal dhe pohoi se të drejtat e punëtorëve abuzoheshin në çdo sektor, përfshirë këtu organizatat ndërkombëtare, ku personeli nuk kishte qasje në sigurim apo pensione.

b. E drejta për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht

Rregulloret e UNMIK-ut u lejojnë sindikatave t'i udhëheqin aktivitetet e veta pa ndërhyrje, dhe UNMIK-u e mbron këtë të drejtë në praktikë. Rregulloret e UNMIK-ut gjithashtu parashikojnë të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht pa ndërhyrje, dhe Qeveria nuk e kufizoi këtë të drejtë në praktikë; megjithatë, negociimi kolektiv nuk ndodhi gjatë këtij viti. Rregulloret e UNMIK-ut nuk e njohin të drejtën për të bërë grevë; megjithatë, grevat nuk u ndaluan në praktikë, dhe greva ndodhën gjatë këtij viti.

Nuk ka zona përpunuese për eksport.

c. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Rregulloret e UNMIK-ut ndalojnë punën e dhunshme apo të detyruar, përfshirë këtu punën e fëmijëve; megjithatë, pati raportime se femrat dhe fëmijët trafikoheshin për shfrytëzim seksual, robëri shtëpiake dhe punë të detyruar në bare dhe restorante.

d. Ndalimi i punës së fëmijëve dhe moshë minimale për punësim

Rregulloret dhe politika e UNMIK-ut ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë këtu ndalimin e punës së dhunshme apo të detyruar; megjithatë, përveç trafikimit, UNMIK-u dhe IPVQ-ja rrallë i kundërshtonin këto praktika. Trafikimi i fëmijëve, kryesisht për shfrytëzim seksual, ishte problem serioz.

Rregulloret e UNMIK-ut e caktojnë moshën minimale për punësim në 16 vjet dhe në 18 vjet për cilëndo punë që mund ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, por lejojnë që fëmijët të punojnë në moshën 15-vjeçare, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon për ta ndjekur shkollën.

Në zonat rurale, fëmijët më të rinj zakonisht punonin për t'u ndihmuar familjeve të tyre. Fëmijët e qytetit shpesh punonin në një sërë punësh jozyrtare të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve dhe kartelave të telefonit në rrugë. Numri i fëmijëve të tillë që punonin në rrugë u rrit në krahasim me vitin 2006, ndonëse as UNMIK-u as IPVQ-ja nuk mbanin të dhëna. Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, IPVQ-së ende i mungonin planet për ta trajtuar këtë formë të rëndomtë të punës joformale të fëmijës. Disa fëmijë gjithashtu angazhoheshin në punë fizike, si transportimi i mallrave. OJQ-të ndërkombëtare që ishin aktive në Kosovë raportuan për shkelje të rënda të rregulloreve të punës gjatë këtij viti, përfshirë këtu punën e fëmijëve.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me UNMIK-un, koordinoi politikën për mbrojtjen e fëmijëve, dhe Departamenti për mirëqenie sociale i Ministrisë ishte përgjegjës për ta siguruar mbrojtjen e fëmijëve; megjithatë, Ministria luajti rol këshillëdhënës në vend se zbatues, dhe kreu shumë pak inspektime gjatë këtij viti.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Ndonëse rregulloret e UNMIK-ut parashikojnë rrogën minimale, asnjë rregullore nuk u miratua. Ndonëse shumë agjenci dhe OJQ ndërkombëtare paguanin rroga përkatëse, rroga mesatare mujore për orar të plotë në sektorin publik prej \$355 (243 euro) dhe rroga mesatare në sektorin privat prej \$444 (304 euro) nuk mjaftonte për të siguruar standard modest të jetesës për punëtorin dhe familjen e tij. Rrogat e sektorit publik iu nënshtruan urdhrit të Fondi Monetar Ndërkombëtar për ngrirje dhe nuk ishin ngritur shumë që nga viti 2003.

Rregulloret e UNMIK-ut parashikojnë javën standarde të punës prej 40 orësh; kërkojnë kohën e pushimit; kufizojnë numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj; kërkojnë pagimin e bonusit për punën jashtë orarit; dhe ndalojnë punën e tepërt të detyrueshme jashtë orarit. Punëdhënësit shpesh dështuan t'i zbatonin këto rregullore për shkak të nënpunësimit dhe papunësisë së madhe.

BSPK raportoi për shkelje të rënda të rregulloreve të punës gjatë këtij viti, përfshirë këtu mungesën e javës standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit; punëtorët nuk i raportonin shkeljet e tilla për shkak të frikës nga reprezaljet. Sipas BSPK-së, shumë punëtorë në sektorin privat punonin me orar të gjatë kinse sipas dëshirës së punëtorëve pa kontratë pune, pa pagesë të rregullt, apo kontribute pensioni të paguara në emër të tyre. Punëtorët raportonin se përjashtoheshin nga puna pa arsye dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe u mohoheshin festat. KMDLNJ dhe KSL raportuan se abuzimi seksual ndodhi në vend të punës, por kaloi pa u raportuar për shkak të frikës nga përjashtimi dhe/apo hakmarrja fizike. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballeshin me keqtrajtim të ngjashëm, përfshirë këtu humbjen e vendit të punës për shkak të lidhjes me parti politike.

Një inspektorat i punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjës për zbatimin e standardeve të punës. Megjithatë, inspektorati kryesisht i këshillonte punëdhënësit, dhe ndonëse shqiptoi 511 gjoba gjatë këtij viti për shkelje të ndryshme të standardeve të punës, ato nuk u paguan në pritje të kontestit gjyqësor. Inspektorati i punës ishte përgjegjës për zbatimin e standardeve të shëndetit dhe sigurisë, por i mungonte personeli i trajnuar dhe nuk vepronte me efikasitet. Ligji nuk u lejon punëtorëve të largohen nga vendet e rrezikshme të punës pa e rrezikuar punësimin e tyre të vazhdueshëm.